

URTËSIA E SHEKUJVE

Përzgjedhi dhe shqipëroi: **Andrea Llukani**

Tiranë, 2001

1

Redaktoi: Viola Adhami
Punoi në kompjuter: Adriana Skëndi
Korrekttoi: Robert Kosti

PARATHËNIE

Njerëzit në kohën tonë janë të ngarkuar me probleme të shumta dhe të lodhur nga vështirësitë e jetës, megjithatë ata kanë nevojë për disa çaste të këndshme shlodhëse duke marrë majanë e mendimit njerëzor, sintezën e tij, ku hynë edhe anekdotat. Këto anekdoda nga urtësia e shekujve dhe jeta e njerëzve të shquar i kemi qëmtuar pas një pune disavjeçare duke shfletuar qindra faqe librash e revistash të ndryshme. Sigurisht që në to është vënë dorë me shtesa e shkurtime me të vetmin qëllim që kuptimi i tyre të dali sa më i plotë dhe kështu të na shërbejë edhe ne në jetën tonë.

GJITHSHKA PËR KRISHTIN

Luftëtari i madh francez Ranzhi, në betejat për çlirimin e atdheut të tij, kishte humbur njërin sy, njëren këmbë dhe njëren dorë. Kur vdiq, mbi varrin e tij u vu ky mbishkrim: “Këtu prehet gjysma e trupit të luftëtarit Ranzhi. Gjysma tjetër mbeti nëpër fushat e betejave”. Nder i madh për njeriun, i cili dha pjesët më të rëndësishme të trupit për atdheun. Po ne ç’ dhamë nga vetja jonë për Krishtin? Sa nder i madh do të jetë për të krishterin, që engjëlli të skalisë mbi varrin e tij: “Dha gjithshka për Krishtin”. Ja vlen që njeriu të sakrifikojë për Krishtin gjithë jetën e tij.

PASTRONI GJUHËN

Në shtëpinë e Gëtes grumbulloheshin shpesh mjaft të ftuar, ku diskutonin për probleme të ndryshme. E vetmja gjë që Gëte nuk lejonte në këto raste, ishte gjykimi i të tjerëve. Në një kornizë që gjendej në hollin e shtëpisë që shkruar: “Shkundni pluhurin e këpucëve tuaja” dhe më poshtë i zoti i shtëpisë kishte shtuar: “Pastroni edhe gjuhën”. Vërtet, sa njerëz marin nëpër gojë çdo ditë nderin dhe dinjitetin e të tjerëve! Për këtë Zoti ynë predikonte: “Mos gjykoni që të mos gjykoheni” (Mateu 7, 2).

BESIMI NË PËRJETËSINË

Botanisti i madh Bufoni, në çastet e fundit të jetës së tij kërkoi që ta nxirrnin në kopësht që të përshëndeste për herë të fundit bimët e tij të dashura. Ishte dimër dhe ato ishin të zhveshura. Bufoni, duke iu drejtuar të afërmeve u tha: -I shihni këto pemë, duken të vdekura. Kështu do të jem edhe unë pas pak, por mos u dëshpëroni! Pemët presin pranverën: edhe unë do të pres pranverën time. Me këto fjalë Bufoni tregoi besimin e tij në përjetësinë. Në dimër vërtet pemët janë të vdekura, por ato nuk zhduken. Kështu ndodh edhe me të krishterët: vdesin, por nuk zhduken, jetojnë me besimin e Ngjalljes.

RRËFIM TË PASTËR

Njëherë një nxënës e pyeti Arkimandritin Kleopa Ilie: - Nëse dikush është i sëmurë, plak, i dobët dhe i varfër, i pamundur të japë lëmoshë, si mund të përgatitet për misteret e shenjta? Ai me urtësi iu përgjigj: -Dëgjo vëlla, Zoti gjithësidashës, nuk kërkon nga njeriu ato që janë të paarritshme për fuqitë e tij. Kështu, nga i sëmuri dhe i pafuqishmi nuk kërkon kreshmë, pagjumësi, metani etj, por vetëm tri gjëra: 1) Rrëfim të pastër e paqe me të gjithë. 2) Zemër të përlulur. 3) Lutje me kënaqësi. “Zemrën e dërrmuar e të përlulur, Perëndia nuk do ta përbuzë” (Psalmi 50).

LUTJA

Lutja është mbretëresha e virtyteve. E gatshme të na ndihmojë, të na nxjerrë nga mjerimi dhe të na çlodhë. Shën Joani i Shkallës thekson: “Kërko me vajtim, kërko me bindje, trokit me zemërgjerësi dhe të jesh i sigurt, se Perëndia do të hapë portat. Ai që lyp merr, ai që kërkon gjen, dhe atij që troket do t’i hapet.

TË PRESËSH NJË MINUTË

Në Indi ka një legjendë, e cila flet për njerëzit që i kërkojnë Perëndisë gjëra absurde. Dikush e pyeti një asket: -Sa janë për Perëndinë 1000 vjet? Asketi iu përgjigj: -Sa një minutë e orës. Njeriu e pyeti përsëri: -Sa është për Perëndinë një mal me thesar? -Sa një monedhë e vetme, iu përgjigj asketi. -Atëhere lutju Perëndisë të më japë një monedhë, - i tha ai asketit. Asketi u lut dhe pastaj iu përgjigj atij njeriu dinak: - Perëndia më tha të presësh një minutë.

KRAHËT E DALLËNDYSHES

Një njeri, që nuk besonte i thoshte dikur Shën Agustinit: - Porositë e fesë janë një barrë, që kufizon lirinjë njerëzore. Në të vërtetë, i lirë është vetëm ai që bën atë që dëshiron. Agustini iu përgjigj: -Krahët e dallëndyshes janë një ngarkesë shtesë në trupin e saj, por në saje të kësaj, trupi i dallëndyshes nuk bie poshtë, por fluturon qiejve. E njejta gjë ndodh edhe me njeriun. Porositë e Perëndisë i duken të rënda, por vetëm në saje të tyre ai lartësohet nga balta dhe robëria e mëkatit, në qiejt e lirisë dhe të lumturisë hyjnore.

ATI IM ËSHTË PERËNDIA

Një princeshë e re shëtiste e vetme në kopështin e babait të saj. Në një çast iu afrua një kopshtar i ri, i cili nuk e njohte dhe e pyeti: - Cila je ti? Ajo me thjeshtësi dhe ëmbëlsi iu përgjigj: - Unë nuk jam asgjë, por babai im është mbreti. Kështu edhe çdo i krishterë mund të thotë: “Unë nuk jam asgjë, por Ati im është Perëndia!” Nga Perëndia, marrim lavdinë dhe madhësinë tonë.

PAQJA E KRISHTIT

Në majë të Andeve, vargmalit që ndan Kilin dhe Argjentinën, në lartësinë rreth pesë mijë metra, ngrihet një statujë kolosale e Krishtit krahëhapur. Ajo u ngrit para 96 vjetësh, për t'u kujtuar popujve fqinjë zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje, që për pak sa nuk i çoi këto dy shtete në luftë midis tyre. Përrurimi i saj është bërë më 13 mars 1904. Në bazamentin e saj gjendet ky mbishkrim i bukur: "Më e lehtë është që të shndërrohen në pluhur këto male, sesa të thyejnë paqen që premtuan përpara shpëtimtarit Krisht popujt e Kilit dhe të Argjentinës.

ZEROT E PËRULËSISË

Një grua e varfër lypi ndihmë nga një i pasur. Atij i erdhi keq dhe i dha një dëftesë për 50 monedha floriri. Ajo nuk e pa sa ishte sasia, por arkëtari e siguroi se i takonin vërtet 50 florinj. Gruaja e varfër, e tronditur u kthye tek bamirësi i saj dhe duke i kthyer dëftesën i tha: - Zotëri, keni bërë gabim një zero. Ai, duke e kuptuar tronditjen e saj e vlerësoi edhe më tepër dhe i tha: - Po, ke të drejtë! Kam bërë një zero gabim. Dhe shkroi edhe një zero tjetër, duke e bërë dëftesën për 500 monedha. Sa më shumë i shmanget dikush nderimit që i bën Perëndia, aq më shumë lavdërohet.

DASHURIA

E pyetën Ava Agathonin, se si mund të shprehet dashuria për të afërmin, dhe ai iu përgjigj: -Dashuria është të gjesh një njeri lebroz dhe me kënaqësi t' i japësh trupin tënd dhe nëse do të jetë e mundur, të marrësh të tijin.

BESIMI DHE PËRULËSIA

U takuan dikur në Moskë enciklopedisti francez Didero dhe Mitropoliti i Moskës Platoni (1730-1812). I thotë Dideroi: -E dini, Hirësi, unë nuk besoj tek Perëndia! –Nuk beson se Perëndia është Ati ynë? Nuk e beson jetën tënde në duart e Tij, në dashurinë e Tij? –Jo hirësi, kjo që thoni ju është diçka e zakonshme. Unë ju thashë diçka të re! –Çfarë është e re? –Unë them, se nuk ka Perëndi! –Të re e quan këtë? E thonë edhe të tjerë! –Kush, kur! –Davidi shkruan: “Tha i marri në zemrën e vet: Nuk ka Perëndi” (Psalmi 13, 1). Ja pra, ju thoni të njenjtat gjëra me atë njeri që jetoi para tremijë vjetëve! Por, me një ndryshim ama. Ai i marri i vjetër hezitonte ta nxirrte nga goja, sepse kishte pak mend dhe i vinte turp nga bota, ndërsa ti e thua lirisht.

VDIQ PËR MUA

Ngjarja e mëposhtme ka ndodhur përpara disa vjetëve në varrezat e një qyteti të Amerikës. Një njeri, i zverdhur nga mallëngjimi, hidhte mbi varrin e një ushtari lule të shtrenjta, të njomura me lotët e tij të nxehtë. Varmihësi kujtoi se aty do të kishte ndonjë të afërm, ndaj iu afrua ngadalë dhe e pyeti me dhembshuri: -Cilin keni? -Nuk e kam të afërm, iu përgjigj ai. -E kam mik. Kur më thirrën për të shkuar në luftë, unë kisha shumë femijë. Ai ishte i lirë dhe shkoi ushtar në vendin tim e vdiq për mua. Të njëjtat fjalë, përsërit çdo besimtar: “Krishti im vdiq për mua”. Pra edhe për ty i dashur lexues ka vdekur dikush! A e mban mend këtë?

OBORRTARËT DHE SHENJTORI

Perandori i Bizantit Kostandini, kishte ftuar në oborrin e tij një murg të shenjtë, të cilin donte ta kishte këshilltar për të gjitha çështjet serioze. Por, murgu me rason gjysmë të grisur dhe sjelljen e tij asketike, stononte brenda luksit të pallatit perandorak. Oborrtarët e korruptuar nuk e duronin dot praninë e tij dhe e komentonin me përbuzje. Kur e kuptoi perandori, i thirri të gjithë në sallën e fronit dhe u tha: -Oborrtarë si ju mund të bëj me dhjetëra të tjerë, por një njeri si ky, vetëm Perëndia mund ta bëjë.

KRISHTI TË PRET

-Krishti eci sipër dallgëve, që të forconte besimin e një nxënësi. –Hyri në shtëpinë e një kryedoganieri, që të shpëtonte një shpirt. –Ndenji tek pusi i Jakovit, që të takonte një grua mëkatare. –U kryqëzua për të gjithë! Tani i pret të gjithë. Të pret edhe ty. A do ti afrohesh?

O JEP QIRANË OSE DIL

“Tha i marri me mendjen e tij: -nuk ka Perëndi”. Të gjitha sa bëhen, kryhen e veprohen në botë e kanë autorin e tyre, që i ka krijuar dhe i mbikqyr. –Nëse nuk ka Perëndi, atëherë ç’punë ke brenda krijesave të Perëndisë? Banon në shtëpinë e Perëndisë dhe mohon të Zotin e shtëpisë? O jep qiranë, domethënë falenderimin tënd, ose dil nga shtëpia. Përse duhet ta tymosësh shtëpinë me frymën e blasfemisë tënde?

QAJ

Qaj! Mo ski turp për këtë. Qaj. Njerëzit qajnë ashtu si ty, në vetmi përpara Perëndisë. –Gjatë natës, - thoshte mbreti David, - do të lag shtratin me lotët e mi. Me këta lot të zjarrtë dhe burrërorë mund të pastrosh të shkuarën tënde dhe të bësh të mbinatyrshme jetën që kalon. Sa e kënaqshme është dhimbja dhe sa e ndritshme errësira, kur jam bashkë me Ty, o Jisu!

VLERA E LUTJES

Janë lutur: -Apostulli Pavli në burg. –Kusari mbi kryq. – Danieli në gropën e luanëve. –Joani në barkun e balenës. –Tre djemtë në furrën e zjarrit... Lutuni edhe ju, kudo që të ndodheni, sepse jeni tempulli i Perëndisë.

NJË LUGË MJALTË

Njëherë, dy udhëtarë takuan në një fshat një plak në moshë të thyer, i cili qëndronte pranë oxhakut të ndezur. –Si t’u duk jeta o gjysh? – e pyetën ata. Ai me urtësi iu përgjigj: -Si një lugë mjaltë. . . . Me të vërtetë jeta ka shumë bukuri. Mjafton që shikimi ynë të mos jetë i drejtuar vazhdimisht përtokë, nga vuajtjet, por të kthehet shpesh drejt lartësive, që të ndriçohet nga drita e qiellit.

AVA ZINONI DHE KRESHMUESI

Jetonte dikur në një qytet të vogël një njeri që kreshmonte shumë, aq sa të gjithë e lavdëronin. Fama e tij arriti deri tek Ava Zinoni. Atëherë, Avai e thirri dhe ai iu përgjigj ftesës. Pasi u përshëndetën, u ulën së bashku. Avai filloi punën e tij të zakonshme dhe ora kalonte me një qetësi të plotë. Kreshmuesi, duke mos duruar dot pa folur, filloi të mërzitet dhe të bëhet nervoz. Më në fund, nuk duroi dot më dhe iu drejtua Avait: -Më jepni uratën tuaj Ava, se do të shkoj. –Përse largoheni? – e pyeti Avai? –Ndiej një shtrëngim në zemër dhe nuk po e kuptoj se ç’ po më ndodh! Kur isha në botë kreshmoja deri në mbrëmje dhe nuk kasha ndonjë vështirësi, ndërsa këtu nuk po duroj dot. –Në botë, -ju përgjigj Avai – ushqehesh nga veshët. Të ushqenin lavdërimet e njerëzve. Shko pra, larg nga lavdërimet dhe të punosh për virtytin, fshehtësisht dhe me mundim.

TANI DO ZËRË VEND

Një i ri u rrëfye tek ati i tij shpirtëror dhe duke u larguar i dha atij një fletushkë me disa emra, për t' i përmendur në Liturgjinë Hyjnore. –Ke shkruar edhe emrin e ndonjë armikut tënd? – e pyeti jerondi. Djaloshi e humbi... –Merre dhe shkruaj edhe emrin e dikujt, që e konsideron si armik – e këshilloi ati shpirtëror. Në mënyrë të pavetëdijshme i riu shtoi edhe dy emra duke ia kthyer përsëri fletushkën. –Tani, do të zerë vend, - e siguroi Jerondi.

T'I FLISNI PERËNDISË

Një nënë ankohej tek ati i saj shpirtëror, se i biri nuk e dëgjonte për ato gjëra, që ajo i thoshte për besimin dhe Perëndinë. Ati shpirtëror e këshilloi: -Ti flisni Perëndisë për fëmijën tuaj dhe jo vetëm fëmijës për Perëndinë.

GJILPËRA

Që të pranojnë njerëzit idetë e tua, duhet të kenë pranuar më parë vlerën tënde dhe personalitetin tënd. Njeriu ngjan me gjilpërën, ndërsa idetë e tij me fijen e perit. Për të kaluar perin mbi basmë, duhet që të kalojmë më parë gjilpërën. Që të pranojë shoqëria idetë e tua, duhet së pari, që ti të bëhesh i pranueshëm për shoqërinë.

QILIMI I ÇMUAR

Zbuluesi i pelicilinës Flemingu, u thirr dikur për të vizituar një zonjë të pasur që rrinte gjithmonë në një kolltuk, me fiksimin që ishte e paralizuar. Flemingu, porositi që t'i sillnin vaj dhe sapo ia sollën, e derdhi mbi një qilim të çmuar persian, që ishte përpara këmbëve të zonjës. -Ej, çfare bëtë doktor?- thirri ajo e tronditur. Më shkatërruat qilimin që kushton një pasuri të tërë! Por duke thënë këto, ishte ngritur në këmbë, e shëruar nga “paraliza” e saj. Njëllor vepron edhe Perëndia me ne. Na i merr të mirat materiale, na e shkatërron “qilimin e çmuar”, për të na dhënë shëndetin e paçmuar të shpirtit tonë.

MË PËRKASIN MUA

Dy fshatarë u grindën për kufinj të arave të tyre dhe pa mundur të gjejnë zgjidhje, shkuan tek një jerond i urtë. Ai i dëgjoji që të dy me vëmendje dhe më pas shkoi bashkë me ta tek arat e tyre. U gjunjëzua tek pjesa e tokës, për të cilën po ziheshin, u përkul dhe e pyeti tokën, se cilit prej të dyve i përkiste? Më pas u ngrit dhe ju tha: -E mora përgjigjen nga toka! -Ç'farë të tha, pra? - e pyetën ata njëzëri. - Më tha se ata të dy më përkasin mua, dhe jo unë atyre.

TRI SITAT

Një thashethemexhi shkoi tek Sokrati duke i thënë: - Mësues, kam për t'ju treguar se një miku juaj.... -Ndalo! - E ndërpreu Sokrati, - kaloje nëpër tri sita atë që do të më thuash? - Cilat janë ato? -E para është sita e së vërtetës. E saktësive, nëse kjo gjë që do të më thuash është e vërtetë? -Jo, sepse vetëm e kam dëgjuar ta thonë: -Atëherë le të shohim mos e kalove nga sita e dytë! Nga ajo e mirësisë, domethënë se ajo që doni të më tregoni, nëqoftëse nuk është e vërtetë a është të paktën diçka e mirë?

Që të jem i sinqertë, jo edhe aq e pëlqyeshme. -Atëherë le të shohim a e kalove në sitën e tretë. Në sitën e nevojës. Pra ajo që do të më thuash, a është e nevojshme. -Me të vërtetë, nuk është edhe aq e rëndësishme. -Atëherë meqë nuk e dini që është apo jo e vërtetë dhe gjithashtu aq e nevojshme, lere mos ma thuaj. Faleminderit nuk dua të ma tregosh.

VLERA E URTËSISË

Dikur një filozof vizitoi një të pasur për t'i kërkuar një sasi parash, të cilat do t'i jepte tek një familje e varfër. I pasuri, për ta ngacmuar e pyeti: -Mund të më thoni, përse i urti troket në derën e të pasurit, ndërsa i pasuri asnjëherë nuk troket në derën e të urtit? Filozofi iu përgjigj: -Sepse i urti e di vlerën e parave dhe di si ti përdorë ato, ndërsa i pasuri nuk ja di vlerën urtësisë.

NË MAJËN MË TË LARTË

Një marinar i ri ende pa përvojë në lundrimet detare mori një ditë një urdhër nga kapiteni i anijes që të ngjitej lart në direk. – Në fshatin tim u qepesha majave më të larta të pemëve dhe të mos i qepem direkt – mendoi marinari. . . . dhe filloi të ngjitej. U ngjit shumë lart, por sa hodhi vështrimin poshtë, në detin që shkëlqente ndjeu paqëndrueshmërinë e direkt, e humbi gjakftohtësinë e filloi të dridhej.

-Mos shiko poshtë, mbaje qëndrimin gjithnjë lart, - dëgjoi zërin kumbues të kapitenit. Marinar i ri u bind, trubullira kaloi dhe ariti në majën më të lartë. Shiko gjithnjë lart, nëse do të ngjitesh drejt majave! Poshtë është bota, paqëndrueshmëria e jetës, pasqyrimi i mëkatit, që me zjarret verbuese errëson qartësinë e kristaltë të mendimit të pastër. Gjithmonë lart!

MËKATAR JAM EDHE UNË

Një europian, pronar i madh tokash në Afrikën e Jugut, pa një bujk vendas që po lexonte Ungjillin dhe i tha me tallje: - Ky libër nuk është për ty! -Si nuk është për mua,- iu përgjigj ai...Pasi ka të shkruar edhe emrin tim aty brenda! – Emrin tënd? Ç’është kjo që thua...? Pa, dëgjo se çfarë shkruan këtu: Jisu Krishti erdhi në botë që të shpëtojë mëkatarët. E dëgjove? Një nga këta jam edhe unë.

ANDONI I MADH DHE GJUETARI

Një gjuetar e pa Andonin e madh duke bërë shaka me bijtë e tij shpirtërorë dhe u çudit. Oshënari duke e këshilluar që të mos gjykonte, i tha: -Tendose harkun tënd... E gjuetari u bind. Oshënari i tha përsëri: -Tendose edhe më tepër. Gjuetari u bind përsëri. Shën Andoni iu drejtua prapë: -Tendose edhe më. Pas kësaj, gjuetari u ankua se po ta tendoste akoma harkun, ai do të thyej. –E njëjta gjë do të ndodhë edhe me vëllezërit murgjër – i tha Shën Andoni, - sepse ata përpiqen rreptësisht dhe me këmbëngulje për virtytin dhe kanë nevojë edhe për pushim e çlodhje.

BËHU MË I MIRË SE ARMIKU

Një athinase pyeti njëherë Sokratin: -Me cilën mënyrë mund ta mposht armikun tim? Filozofi i madh iu përgjigj: -Nëse dëshironi ta mundni armikun tuaj, duhet të bëheni më e mirë nga ai.

PËR KË U KRYQËZUA KRISHTI

Dikur, një murg shpërndante disa medaljonë të vegjël, ku në pjesën e pasme ishte shkruar: “A e dini se për kë u kryqëzua Krishti? –Ktheje medalionin nga ana tjetër e të shohësh”. Në kthim një pasqyrë e vogël tregonte fytyrën e atij që mbante medalionin. Kjo është një mënyrë për të kujtuar një të vërtetë. Krishti u kryqëzua në Golgotha për ty dhe për mua, për ne të gjithë. Sakrifikimi i tij u bë për shpëtimin tonë.

NË QOFTË SE....

Një general barbar persian i dërgoi një ultimatum mbretit të Spartës, Lisandrit. Në të thuhej se ai kishte ushtri dhe armatime të shumta dhe e kërcënonte, se në rast mosnënshtrimi, ai do të hakmerrej duke djegur e plaçkitur Spartën. Lisandri fjalëpak iu përgjigj ultimatumit të barbarit shkurt dhe prerë: -Në qoftë se.....

EDUKATORJA E TRASHËGIMTARIT

Njëherë, Napoleoni kishte shtruar një drekë, ku merrte pjesë edhe zonja Monteskje. Ndërsa të gjithë të pranishmit filluan të hanin plot oreks menunë e pasur, zonja që kish zënë vend përballë perandorit, nuk po hante. Napoleoni e vështroi në mënyrë pyetëse dhe zonja iu përgjigj, se ishte e premtë dhe të krishterët këtë ditë kreshmojnë. Të pranishmit filluan ta shihnin me ironi zonjën që kreshmonte por, ndryshe do të reagonte Napoleoni. Ai e kishte vlerësuar qëndrueshmërinë e karakterit të zonjës Monteskje dhe që nga ajo ditë, ajo u bë edukatorja e trashëgimtarit të fronit.

LUMTURIA NUK BLIHET

Nuk ka dyshim, që po të kesh shumë para mund të blesh një pallat të tërë. Mund të blesh veshje e sa gjëra të tjera të bukura, veçse jo bukurinë e shpirtit. Mund të shpërblesh shumë mjekë kur të sëmuresh, por kurrë nuk mund të blesh me para shëndetin tënd....Lumturia asnjëherë nuk blihet me para. Nevojitet një monedhë tjetër.

IMITOVA TË VERBËRIN

E pyetën njëherë një asket: -Si është e mundur Jerond, që keni kaluar në rrugën e vështirë të jetës pa rrëshqitur. Ai iu përgjigj: -Imitova të verbërin. Ky i fundit i beson shkopit të tij, e mbështet atë dhe e pyet në çdo hap. Kështu, edhe unë i besova Perëndisë; u mbështeta në mësimet e Tij dhe me shkopin e besimit, kërkova me kujdes tokën, përpara se të vendosja këmbën.

PËRQAFIMI HYJNOR

Hektori, mbreti i trojanëve, i veshur me mburojat e hekurta, deshi të përqafonte të birin e tij të vogël. Fëmija u tremb, filloi të qante dhe u largua. Atëherë Hektori e kuptoi dhe i zhveshi armët. I vogli duke e kuptuar se pas atyre veshjeve fshihej ati i tij, iu hodh në krahë për ta përqaftuar. Diçka e ngjashme ndodh edhe me mbretin tonë Jisu Krishtin, i cili mori natyrën njerëzore, me qëllim që t' i afrohen njerëzit, për t' i drejtuar ata drejt përqaftimit hyjnor.

PREDIKIMI MË I MIRË

Një asket së bashku me bindësin e tij shkuan në një qytet, për të predikuar. Kaluan nëpër rrugët e qytetit gjatë gjithë ditës, me seriozitet, thjeshtësi dhe të kujdesshëm në çdo hap që hidhnin. Ndërsa dielli po perëndonte, bindësi e pyeti asketin se kur do të predikonin për Krishtin. Në çast jerondi iu përgjigj: -Predikimi u bë. Pra serioziteti i tyre, thjeshtësia e përlësia, ishin predikimi më i mirë për banorët e atij qyteti. Njerëzit në epokën tonë janë të lodhur nga moralizimet, premtimet etj. Tashmë ata kërkojnë shembuj jetese, dhe krishterimi është shembulli më i mirë. Le të mos e harrojmë këtë.

NËNA

E pyetën dikur predikuesin e madh Dr. Morgan, se cili është predikuesi më i madh në familje. –Nëna, -iu përgjigj ai. Është ajo që i mëson fëmijës lutjet e para; është ajo që ia bashkon të tre gishtat në shenjën e kryqit dhe e drejton për tek ikonastasi; ajo që pikturon në shpirtin e fëmijës ikonën e parë të Krishtit.

PARATË

Shën Ambrozi përpara se të zgjidhej Episkop i Milanos, zotëronte pasuri të madhe. Veçse, pasi u bë episkop, ai ua shpërndau të varfërve gjithë pasurinë. Sa herë që të afërmit e tij e pyesnin për këtë gjest fisnik ai iu përgjigjej: -Kurrë nuk do të ngjitesha në fronin episkopal, duke mbajtur në xhepin tim, qoftë edhe një monedhë të vetme. Kurrë njeriu i Perëndisë nuk duhet të bëhet skllav i parave, por duhet t’i zotërojë ato, dhe të dijë si dhe ku t’i përdorë.

DIOGJENI KËRKON

Aleksandri i madh pa dikur Diogjenin, duke kërkuar me qiri në dorë ndërmjet kafkave të të vdekurve. E pyeti se ç' ishte duke bërë dhe filozofi iu përgjigj: “Madhëri, kërkoj kafkën e babait tuaj, por fatkeqësisht nuk mund ta dalloj”. Këtë e bëri, për të treguar se vdekja i njëson të gjithë dhe nuk pyet nëse je mbret apo skllav, i pasur apo i varfër. Vdekja është e vetmja që sjell barazinë ndërmjet njerëzve.

DORA E PERËNDISË

Në një qytet të madh njerëzit donin të ndërtonin një Kishë. Për atë që do të jepte më tepër, dora e Perëndisë do të shkruante më gërma të theksuara emrin e tij mbi dyert e Kishës. Të gjithë ishin gati të jepnin atë që kishin, por më shumë ofroi mbreti. Kur përfundoi së ndërtuari Kisha, të gjithë besonin se dora e Perëndisë patjetër do të shkruante emrin e mbretit, por ndodhi diçka krejt e papritur. Ishte shkruar emri i nje plake të varfër. Atëhere mbreti e ftoi dhe e pyeti se ç' farë kishte ofruar ajo. “Asgjë mbreti im – iu përgjigj plaka e varfër. – Vetëm kur buajt që tërhiqnin qerret e ngarkuara me mermer për Kishen, turfullonin ndërsa ngjiteshin në malore, unë shkoja i përkëdhelja dhe u jepja ujë. Kjo ishte e gjitha. Para nuk dhashë, sepse nuk kam”. Në sytë e Perëndisë kurrë nuk shkëlqejnë sasi të që ofrojmë, por mënyra se si ofrojmë. Perëndia sheh dëshirën e mirë të njeriut dhe në mënyrë analoge gjykon e vendos.

BURIMI

Shpirti i ngjan një burimi. Burimin sa më shumë që ta hapësh aq më të kulluar e nxjerr ujin dhe kur e mbulojnë me dhe ai humbet. Kështu ndodh edhe me ndërgjegjen. Kur bën ato që të kërkon ajo, atëherë shpirti bëhet më i pastër, ndërsa kur të tjera thotë ndërgjegjia dhe të tjera bën ti, atëherë shpirti priset.

SKULPTORI HYJNOR

Njëherë, një skulptor godiste me forcë një bllok mermeri. Ndërsa daltat e mprehta vijëzonin mermerin, ky i fundit filloi të ankohej: -Përse më godet? E skulptori iu përgjigj: -Të godas sepse të dua të mirën. Dua të të jap një formë të ëmbël, që kur të të shohin, të mrekullohen nga kryevepra e artit. Sa e sa herë edhe ne i pranojmë goditjet e “Skulptorit Hyjnor” e nuk përtojme të themi: “Përse Perëndia im, më bëni të vuaj?” Por harrojmë se dhimbjet e vuajtjet janë veglat e punës të “Skulptorit Hyjnor”, që gërryen shpirtin tonë, për të krijuar një kryevepër të vërtetë.

KËMBËNGULJA E DASHURISË

Oshënar Kristodhuli zbriti njëherë nga shkretëtira në Aleksandri dhe u vinte rrotull shpëpive të të pasurve, duke kërkuar para për t'ua shpërndarë të varfërve. Veçse një nga të pasurit refuzoi, madje i foli me të keq, por Oshënari sikur të mos kishte ndodhur gjë, këmbëngulte t'i kërkonte. Atëherë, ai e qëllloi në fytyrë, por shenjtori i tha përsëri: -Faleminderit. Kjo shuplakë ishte për mua, tani të lutem më jep diçka për të varfërit.

PERËNDIA I SHEH TË GJITHA

Shën Pafnuti dikur mësoi për një grua mëkatare, që jetonte në Aleksandri. Shenjtori vendosi që ta shpëtonte atë grua. Një ditë, ai u paraqit tek shtëpia e saj. Gruaja e pranoi me gëzim dhe e vuri në dhomën më të mirë, por vizitori nuk u kënaq. Nuk keni ndonjë dhomë tjetër, që të mos na shohi asnjë sy, - i tha shenjti. – Po këtu asnjë nuk na sheh, - tha ajo. Vizitori e pyeti: -As Perëndia? Gruaja qëndroi e heshtur.

-Si mund t'i bësh këto gjëra të turpshme, përpara syve të Perëndisë, veprime të cilat nuk do të guxojë t'i bëjë as përpara syve të njerëzve? Pikërisht këto fjalë e bënë gruan mëkatare të pendohet dhe të ndryshojë rrugë. Sa e sa njerëz i shkelin ligjet hyjnore, e njerëzore, me mendimin se askush nuk i sheh....gabohen. Na sheh Perëndia. Askush nuk mund t'i fshihet syve të Perëndisë.

PASTRONI UDHËN

Dikur një grua e moçme, duke ecur nëpër rrugë, shpesh përkulej për të mbledhur diçka. Një udhëtar e pa dhe e pyeti: - Çfarë po mbledh gjyshe? Ajo iu përgjigj: -Këto qelqet e thyera, që të mos dëmtojnë këmbët e fëmijëve që do të kalojnë nga kjo udhë. Sa mirë kishte menduar gruaja e moçme. Nëqoftëse edhe ne do të pastronim ato që ndeshim gjatë udhës dhe këtë gjë do ta bënim jo vetëm për veten tonë, por edhe për ata që do të na vijnë pas, udha e besimit do të jetë gjithmonë e pastër.

DUART MË TË BUKURA

Njëherë, disa zonja u mbledhën në një salon bukurie në konkursin “Duart më të bukura”. Në juri, ndërmjet të tjerëve ishte edhe një jerond i urtë. Pas konkurimit, jerondi refuzoi të jepte konkluzionet. –Nuk mundem – tha, do të pyes të varfërit dhe ata do të më ndihmojnë, sepse besoj se duart më të bukura janë ato duar që ngopin një të uritur dhe ujitin një të etur, që mbledhin lotët e një jetimi, e që kufizojnë dhimbjen e një shpirti të lënduar. Janë ato duar, që shpërndajnë gëzimin tek gjithë njerëzit.

VDEKJA DHE TË URTËT

Përpara varrit të Aleksandrit të Madh u mbloodhën disa të urtë. Secili prej tyre dëshironte të linte një mbishkrim mbi varr. Thotë i pari: Dje nuk të mjaftonte e gjithë toka, ndërsa sot të mbuluan me pak dhe. Thotë i dyti: Dje zotëroje gjithë popujt, ndërsa sot askush nuk të dëgjon. Thotë i treti: Deri dje shkelje tokën, ndërsa sot toka po të mbulon. Thotë i katërti: Dje të nderonin të gjithë, ndërsa sot askush nuk të respekton. Me të vërtetë sa shpejt shuhet lavdia njerëzore! I krishteri, veçse nuk frikësohet nga vdekja. Lavdia e besimtarit është në qiell dhe vdekja është stacioni i fundit, ku njeriu përcillet nga toka për në qiell.

SHPORTA E DASHURISË

Dikur heremit Makarit i dhuruan një shportë me rrush. Heremiti ra në mendime, ta mbante për vete, apo t'ua jepte vëllezërve të tjerë. Dashuria për vëllezërit fitoi mbi ngacmimin. Ai mendoi se gjitoni im do të ketë më tepër nevojë për to dhe ja shpuri, por edhe ky heremit mendoi në të njëjtën mënyrë. Kështu, shporta shëtiti nëpër të gjitha qelitë e skitit dhe më në fund mbërriti përsëri në qelinë e Makarit, pasi kishte përshkruar një rreth të plotë. Ishte rrethi i dashurisë. Ai e sheh vëllain e tij si veten. Sa e mrekullueshme është dashuria, kur zotëron zemrat e njerëzve.

DO TË RIBOTOHET

Pak kohë para se të vdiste, Benjamin Franklin përgatiti epigramën e mëposhtme, që ta vinin mbi varrin e tij. “Këtu dergjet Benjamin Franklin, ish tipograf. Trupi i tij do të haet nga krimbat, por libri i tij nuk do të humbasë. Do të ribotohet me fletë që nuk prishen dhe kopertinë më të bukur, në ditën e Gjykimit nga shtëpia botuese e Mbretit Qiellor”.

TRIMËRI DHE MIRËSJELLJE

Në kohën e përndjekjeve të Dioklecianit, ushtarët kërkonin të kapnin episkopin e Antiokisë, Anthimin. Papritur, ashtu siç qenë të lodhur dhe të zemëruar, gjenden përpara atij që kërkonin. E pyetën nëse e dinte se ku ndodhej Anthimi? Ky i fundit me mjaft qetësi iu përgjigj: -Ju shoh se jeni mjaft të lodhur, uluni të çlodheni dhe do t’ju ndihmoj unë për të gjetur atë që kërkonin. Pasi i priti mirë ushtarët, doli përpara tyre dhe u tha: “Tani jam në dispozicionin tuaj. Unë jam Anthimi.

“FIDANI I MBRETIT”

Njëherë në Romën antike, në kopshtin mbretëror ekzistonte një fidan, që askush nuk kishte të drejtë ta prekte. Një tabelë me mbishkrimin: -”I mbjellë nga dora e mbretit” – tregonte qartë të zotin e fidanit dhe kështu ky fidan ishte i respektuar nga të gjithë. Fidan i mbretërisë është çdo i krishterë. Emri i krishterë tregon qartë atë që e zotëron, sepse emri i krishterë nuk është vetëm titull, por edhe tregues sigurie dhe pronësie.

KU TË SHPIE MËKATI

Piktori i madh Leonardo Da Vinci filloi të pikturonte Darkën Mistike. Duke kërkuar një model për personin e Krishtit u gjend një ditë në një kishë të madhe. Diku në një qoshe sheh një të ri që po lutej përpara ikonës së Krishtit. I afrohet dhe i propozon atij për modelin e kërkuar. I riu pranoi që të bëhej model për fytyrën e Krishtit. Leonardo, pasi përfundoi fytyrën e Krishtit, kërkonte një model për fytyrën e Judës. Një ditë, në kërkim e sipër gjen një hajdut dhe i propozoi që ta përdori si model. Ai pranoi dhe piktori e shpuri në studion e tij. E uli në një karrige për ta pikturuar, por djaloshi filloi të qante. Çfarë pate e pyeti artisti? I riu iu përgjigj: - Në të njëjtën karrige, dikur isha ulur për të pikturuar fytyrën e Krishtit, ndërsa tani jam ulur për të pikturuar fytyrën e Judës. Perëndia im, ku u katandisa! Me të vërtetë, mjeshtri vuri re se ishte pikërisht ai, që fytyra e tij ndriste si fytyra e Krishtit, dhe tani me pamjen cinike, të kujton fytyrën e Judës. Ja se ku e kishte katandisur mëkati. Me të vërtetë, ku e shpie mëkati njeriun!!!

PERËNDIA I JEP TË GJITHA

Një fjalë e urtë kineze thotë: “Kur hëna mbushet me dritë, shih si do të shuhet, por kur humbet në qiell ta dish se shpejt dotë shfaqet”. Kjo ndodh edhe me jetën e njeriut, Vijnë çaste që jeta jonë është si “Hëna e plotë”, e mbushur me gëzime e bekime nga Perëndia, por vijnë ditë kur “Hëna e jetës” humbet dhe dëshpërimet e provat na mendojnë. I krishteri kurrë nuk duhet të humbasë. Përpiqet gjithnjë, që nga bekimet e shumta, por edhe nga sprovat e vështira të ruajë gëzimin e lumturinë, sepse e di që Perëndia na i ofron këto për të mirën tonë.

EKZISTON SHPIRTI

Një mjek ateist i thotë një të krishteri: -Nuk ekziston shpirti. A e ke parë ndonjëherë me sytë e tu shpirtin? Ke dëgjuar me veshët e tu ndonjë shpirt? A ke shijuar ndonjëherë shijen e shpirtit? Jo – u përgjigj i krishteri. E sheh pra, se gjithë këto shqisa na informojnë se nuk ekziston shpirti.

I krishteri e pyet mjekun: -A e ke parë ndonjëherë doktori im, me sytë e tu dhimbjen? A e ke dëgjuar me veshët e tu? E ke shijuar me gojën tënde? –Jo – përgjigj doktori. –Por a e ke ndjerë dhimbjen? –Po – iu përgjigj doktori. E sheh pra doktori im, kemi shqisa që na thonë se nuk ekziston dhimbja, por ajo ndjehet.

VDEKJA E ËMBËL

Mjeshtri i madh i muzikës, Shopen, kur gjendej në çastet e fundit të jetës, u vizitua nga një miku i tij prift, që i thotë: -Sot feston një miku yt, e di se sa e doni. Çfarë dhurate mendoni t’i bëni? Shopeni iu përgjigj: -E ç’dhuratë mund t’i jap unë në këto çaste? Vetëm shpirtin tim!!!

Pasi tha këto fjalë, Shopeni bëri kryqin dhe u rrëfye. Atë natë mbylli sytë, duke ja dhënë shpirtin e tij Perëndisë. Me të vërtetë sa e ëmbël është vdekja, kur shpirti gjen paqe te Perëndia!

HIJA E MBRETIT

Mbreti i Maqedonisë Filipi, pas çdo beteje që fitonte bëhej si i dehur nga sukcesi. Ai kishte delirin e madhështisë. Njëherë, një miku i tij, mbreti i spartanëve Arqidhami, i tha: ‘Filip, pa shih hijen tënde në diell. Aspak nuk u zmadhua edhe mbas bëmave të tua’.

PASURIA MË E MADHE

Njëherë, një pronar i madh tokash mburrej përpara një bujkrobi të tij: -I sheh ato tokat atje tej, livadhin e gjelbër, kodrën atje tutje si dhe lumin që përshkon fushat? Të gjitha të mijat janë. – Epo mirë, iu përgjigj bujkrobi. Po qielli që është sipër tyre i yti është? –Qielli! Sigurisht, iu përgjigj i pasuri. -Qielli është prona ime, - tha me gëzim bujkrobi. Unë i lutem gjithnjë Perëndisë dhe mezi pres çastin që të ftohëm për të jetuar atje lart, në Mbretërinë e Qiejve.

THJESHTËSIA

Filozofi kinez Lion Ce Kang vishej gjithmonë thjesht. Kurrë nuk i jepte rëndësi paraqitjes së jashtme. Një mik i tij, njëherë e pyeti: -Përse visheni kaq thjesht? Filozofi iu përgjigj: -Të gjithë e dinë se cili jam. Mos harroni se njeriun nuk e tregon paraqitja e jashtme, sepse nën veshjet e thjeshta shpesh fshihen zemra të pastra.

ZEMËRGJERËSIA E KOSTANDINIT

Gjatë një kryengritje popullore, rebelët qëlluan me gurë përmbi statujën e Kostandinit. Gurët ranë si breshër, duke ia dërrmuar fytyrën trimit. Më pas, oborrtarët zunë shumë nga kryengritësit dhe i sollën tek Kostandini të irituar. –Madhëri! – Ç’ dënim jepni për këta që qëlluan mbi fytyrën tuaj të nderuar? – Ç’ janë këto që më thoni, iu drejtua atyre Kostandini, duke kaluar gishtërinjtë nëpër fytyrë. –Unë nuk kam asnjë plagë siç e shihni, prandaj ata që keni zënë lërinë të lirë.

NËNA E KRISHTERË

Nëna! Sa shumë i detyrohet shoqëria nënës së mirë e shprestare. Është heroi i padukshëm, që punon në thellësi dhe bën të qëndrueshme themelet e shoqërisë dhe të Kishës. –Gjthçka që jam bërë ia dedikoj nënës sime – thoshte Thomas Edison. –Nëna më tregonte besimin e vërtetë, më bënte të ndjeja se kisha dikë, për hir të së cilit jetoja dhe të cilin nuk duhet ta zhgënjeja... E çfarë mund ta zëvendësojë atë thesar, që mban emrin nënë e krishterë!

NGJYRA MË E BUKUR

Njëherë, në shtëpinë e Aristotelit ishin mbledhur filozofët për të diskutuar, se cila ishte ngjyra më e preferuar. Dikush preferonte të kuqen, një tjetër të verdhën etj. Më në fund filozofët pyetën vajzën e Aristotelit. –Unë – ju tha ajo – do të preferoja ngjyrën e njeriut, sepse kjo është ngjyra e virtytit, është ngjyra e bukurisë së vërtetë.

TË KRISHTERËT NË FUND DUKEN

Në lashtësi pyetën njëherë luftëtarin Epaminonda, se cilin quante më trimin, Haviarin, Ifrikatin apo veten e tij? Ai me urtësi iu përgjigj: -”Prisni të vdesin njëherë, më pas i gjykoni”. Me të vërtetë, askënd nuk duhet ta lumërojmë pa parë fundin e tij. Të krishterët në fund të jetës duken. Siç uron edhe kisha jonë: “Mbarim të krishterë të jetës sonë, pa dhimbje, faqebardhë, me paqe dhe mbrojtje të mirë përpara gjykatores së frikshme të Krishtit, le të lypim”.

MËKATI

Dikur Ezopi tregonte: Një mace hyri njëherë në punishten e një marangozi. Atje gjeti një limë, e cila vinte erë peshk. Mbase peshqit i pëlqenin shumë, menjëherë filloi të lëpinte limën. Veçse, gjakosi gjuhën, duke menduar se ushqehet me ushqimin e preferuar. E njëjta gjë ndodh edhe me njeriun mëkatar. Sa herë atij i pëlqen mëkati, ushqehet me gjakun e tij, duke shkatërruar jetën e vet. Ashtu siç thotë edhe apostull Pavli: -"Ai që ushqehet me mëkatin, gjen vdekjen" (Rom. 6, 23).

NËSE DO TË SHPËTOSH

Njëherë, një murg vajti tek avai Makarios Egjiptiani dhe i thotë: -Ava, më thuaj si mund të shpëtoj? Jerondi i tha: -Shko tek varrezat dhe shaj të vdekurit. Shkoi murgu tek varrezat, i shau të vdekurit dhe u kthye e ia tregoi avait. Atëherë, avai i thotë: -Shko përsëri nesër dhe thurrju himne të vdekurve. Murgu u kthye përsëri tek avai e i tha: -Asnjë nuk m'u përgjigj. Jerondi i tha: -E pe, kur i poshtërove nuk t'u përgjigjën. Edhe kur i himnove përsëri nuk të folën. Ashtu bëj edhe ti, nëse do të shpëtos. As padrejtësitë e njerëzve dhe as himnet e tyre mos i llogarit dhe do të shpëtos.

SHEMBËLLTYRA E PERËNDISË

Kirurgu me famë Bunton u thirr me urgjencë për të operuar kryeministrin e Francës Dumona. Kur po e shpinin për në sallën e operacionit kryeministri i tha: -Mos harroni se jam i pari i vendit dhe mos më trajtoni si klientët e tu të mjerë! Por mjeku me guxim iu përgjigj: -Shkëlqesi, çdo njeri është për mua një kryeministër. Vërtet cilado qenie njerëzore është shembëlltyra e Perëndisë dhe as gradat e as titujt nuk i japin rëndësi.

PËRULËSIA

Dikur djalli iu shfaq një shenjtori dhe i tha: Ti je një hiç! Atë që bën ti e bëj edhe unë. Punon ti, punoj edhe unë, kreshmon ti, unë nuk ha fare. Bën agripni ti, unë nuk fle fare. –Jo or djall – iu përgjigj shenjti. Ti vërtet mund t’i bësh të gjitha këto, por vetëm një gjë nuk mund të bësh. Është pikërisht ajo, që bëjnë shenjtorët e Perëndisë. Ti nuk mund të përulesh. Djalli nuk mund të përulet kurrë.

PRINDËRIT

Një legjendë na thotë se na ishte njëherë një dallëndyshe, e cila kishte pesë zogj. Me mjaft mundim i ushqeui derisa u rritën. Një ditë, dallëndyshja u plak dhe nuk mund të ushqehej vetë. Ajo mblodhi zogjtë e saj dhe iu lut që ta ndihmonin. Dallëndyshtet e saj pranuan dhe filluan t' i binin ushqime nënës së tyre. Kjo punë vazhdoi disa kohë e më pas zogjtë e lanë në harresë nënën e tyre. Pra, një nënë ushqeui pesë zogj, ndërsa të pestë zogjtë nuk mundën të ushqenin dot një nënë. Sa e sa shembuj të tillë ndodhin në shoqërinë e sotme, që fëmijët i braktisin prindërit e tyre.

ATEISTI

Volteri një ditë, duke diskutuar me një besimtar, i thotë: - Unë e shes vendin që kam në parajsë për pesë franga. Besimtari iu përgjigj: -Nëqoftëse mund të ma vërtetoni se keni një vend në parajsë, unë jam gati t' ju jap të gjithë pasurinë time.

VIRTYTI

Mbreti i Francës, Karli i 9-të e pyeti njëherë poetin e famshëm Torkuato Taso: -Cili është njeriu më i sukseshëm? Poeti iu përgjigj: -Perëndia. -Mirë mirë – i tha mbreti, po mbas Perëndisë? Dhe poeti i tha: -Ai që ngjan më shumë me Perëndinë. Mbreti e pyeti sërish: -E çfarë na bën që të ngjajmë me Perëndinë, fuqia, pasuria? -Virtyti –iu përgjigj poeti. Ashtu siç thuhet në Bibël: “T’i shtoni besimit tuaj virtytin, dhe virtytit diturinë, diturisë vetëkontrollin e vetëkontrollit qëndresën, qëndresës perëndishmërinë” (Letra e dytë e Petros, vaegu 5).

DUAJE ARMIKUN

Njëherë gjenerali Silvester Ugo po kalonte përmes fushës së betejës. Papritur dëgjoi një klithmë. Ishte një ushtar armik i plagosur rëndë që kërkonte pak ujë. Gjenerali, mori paguren, por në kohën që matej për t’i dhënë të pinte, i plagosuri nxori pistoletën dhe e qëlloi, por fatmirësisht pa e prekur. Gjenerali trim nuk u tërhoq. U përkul përsëri me paguren në dorë. Lipset guxim dhe heroizëm, për të treguar dikush dashurinë për armikun. Për këtë Zoti ynë na mëson: “Nëqoftëse armiku yt ka uri, jepi të hajë, në pastë etje, jepi të pijë” (Romakëve 12, 20).

MONEDHA E MIRËSISË

Njëherë, Dostojevski ishte duke bërë shëtitjen e mbrëmjes. Ashtu, duke ecur i shkujdesur, dëgjo i zërin e një lypseje, që i kërkoi t' i jepte dicka. Dostojevski kërkoi nëpër xhepa për të gjetur ndonjë monedhë, por më kot. Atëherë, shkrimtari i madh u ul në gjunjë dhe duke i puthur dorën lypëses i thotë: -Të më falni, sepse në këto çaste nuk më ndodhet asnjë monedhë. Lypsjja iu përgjigj: -Të faleminderit. E mora monedhën. Atë që më dhatë juve, nuk ma ka dhënë askush tjetër. A ka monedhë më me vlerë se monedha e mirësisë?

TETË GROSHËT

Njëherë, mbreti i Prusisë Frederiku pa një bujk që po lëronte arën. –E jotja është kjo arë? e pyeti mbreti. -Jo, -iu përgjigj bujku. Punoj si argat dhe marr tetë groshë. -Të dalin kaq pak? e pyeti sërish mbreti. –Mund t'ju them se më teprojnë – i thotë argati. Dy groshë më duhen për t' u ushqyer. Dy groshë kam detyrim ndaj dikujt. Dy të tjerë i jap borxh dhe dy të tjerë që më mbeten ia jap Zotit tim. –Por si është e mundur kjo? – pyeti përsëri mbreti. Bujku e sqaroi: -Dy groshët janë për t' u ushqyer unë dhe gruaja ime. Dy groshë ua jap prindërve të mi në shenjë mirënjohjeje. Dy të tjerë ua jap fëmijëve të mi duke ua kujtuar se m' i kanë borxh kur të plakem dhe dy groshët që më mbeten, ua jap lypsave në emër të Krishtit.

“BAGAZHET” E TË KRISHTERIT

Njëherë, një i krishterë përgatiste valixhet për një udhëtim të largët. Ai filloi të vendoste të gjitha senset e nevojshme por, një cep i valixhes i ngeli bosh. Shumë bukur, tha: “Këtu do të vendos një pasqyrë, një elektrik dore, një teleskop dhe një bibliotekë të vogël...” Miku i tij u çudit dhe e pyeti: -Si është e mundur, që të vendosësh atje, të gjitha sa thatë?!... vendi është mjaft i vogël. Atëherë, i krishteri nxori nga xhepi i tij një Ungjill dhe e vendosi në valixhe. Miku e kuptoi se çfarë donte të thoshte. Ungjilli është pasqyra e shpirtit të njeriut. Ai është fanari ndriçues, që errësirën e jetës e ndriçon në çdo hap. Ungjilli është teleskopi më i përsosur, me të cilin do të mund të shohim drejt përjetësisë, në Mbretërinë e Qiejve. Ungjilli është libri që zëvendëson një bibliotekë të tërë.

MËKATET E VOGLA

Një alpinist iu ngjiti majave të maleve për 30 ditë rresht. Kur përfundoi alpinizmin, deklaroi se nuk e kishte lodhur edhe aq ngjitja nëpër majat e maleve sesa ecja nëpër shkretëtirë, përmes rërës së imët që i hynte nëpër këmbë e vështirësonte udhëtimin e tij. E njejta gjë ndodh edhe me çdo të krishterë. Me lehtësi i kalon vështirësitë e mëdha, sepse mëkatet që duken kalohen, por më e vështirë është në çikërimat e vogla të përditshme: një gënjeshtër e vogël, një vështrim me qëllim të keq, një mendim i lig, një diskutim i hidhur. Mëkatet e vogla, të cilat njeriu nuk i vë re, na pengojnë të ecim në rrugën e jetës së krishterë.

BRAKTISJA

Në të dalë të Tokios gjendet një manastir i krishterë. Atje jeton një murg, i cili ka arritur deri në majat më të larta të shenjtërisë. Murgu Tohito Jamoto përpara se të vinte në manastir bënte një jetë shumë mëkatore. Një ditë siç qe i dehur, duke drejtuar automjetin goditi për vdekje një fëmijë. Kaloi sipër kufomës dhe e braktisi të aksidentuarin pa i dhënë ndihmën më të vogël, por të nesërmen mësoi nëpërmjet gazetave, se i aksidentuari ishte fëmija i tij. Kjo ngjarje e preku aq shumë saqë rilindi brenda tij një botë tjetër. Pasi u pendua thellë për atë që bëri, ai e braktisi botën, për t'ju përkushtuar Perëndisë. Sa njerëz edhe sot i braktisin ata që aksidentojnë pa ju dhënë asnjë ndihmë. Po nëse do të mësonin, se ai që u aksidentua do të ishte fëmija i tyre, si do të reagonin?

UNAZA E FLORINJTË

Dikur, një mbret i vendosi një statujë në njerën dorë një unazë teneqeje e në dorën tjetër një unazë floriri. Kur e pyetën se ç'donte të tregonte me këtë veprim, ai iu përgjigj: Unaza prej teneqeje simbolizon miqësinë e rreme, ndërsa unaza e florinjtë, miqësinë e vërtetë. Kishte të drejtë mbreti, sepse kur njerëzit nuk janë të sinqertë dhe miqësia e tyre i ngjan një unaze teneqeje, e cila me kalimin e kohës fillon e ndryshket. Ndërsa miqësia e vërtetë është si floriri i pastër dhe kurrë nuk e humbet vlerën e saj. Në çastet e vështira, kjo miqësi nuk humbet, por e tregon vlerën e saj të vërtetë.

DUKE U LËPIRË

Njëherë, një kërmill u ngjit në majën më të lartë të një shkëmbi. Një shqiponjë e pa dhe u çudit. Si është e mundur thotë, që një kërmill të ngjitet kaq lart? E kërmilli ia ktheu përgjigjen: “Duke u jargavitur dhe duke u lëpirë pas shkëmbit”. Në ditët që jetojmë vëmë re shpesh disa “kërminj” (njerëz të paaftë) që të ngjiten në majat më të larta, në poste, vetëm duke u lëpirë. Dhe është fatkeqësi kur sheh njerëz të tjerë me vështrim shqiponje dhe me mendje të fuqishme, duke qëndruar të zhgënjyer dhe të mënjanuar.

MËKATI NA KËRCËNON

Thonë, se dikur mbreti i Francës Karli i 5-të bënte shpesh shaka me berberin e tij. Veçse një ditë kur tehu i briskut kalonte lehtë-lehtë në grykën e mbretit, berberi i thotë: “Madhëri, a e dini se jeta juaj kalon nëpër tehun e briskut tim”? Mbreti menjëherë u shqetësua, u përtyp pak, e zemra filloi t’i rrihte më me force dhe që nga ai çast mori vendimin që të mos gjendej më nën tehun e mprehtë të briskut të berberit.

Rolin e berberit shpeshherë e zë mëkati, i cili na buzëqesh e përkëdhel, por gjithmonë jemi nën kërcënimin e tij. Vallë kur ne do të marrim vendimin ta dëbojmë rrezikun që na kërcënon? Kur do t’i themi mëkatit ndal? Ka ardhur koha....

DIELLI DHE LULET

Dikur, poeti i famshëm anglez Tenson, shëtiste në një kopësht të bukur me lule. Një kalimtar e pyeti: - Zoti Tenson, ju kam dëgjuar të flisni me plot pasion për Krishtin dhe jam kureshtar të di se ç'farë ka bërë ai për juve? Poeti iu përgjigj: - Atë që ka bërë dielli për këto lule që sheh. Me të vërtetë, pa dritën e diellit dita bëhet natë, ndërsa për çdo besimtar, Krishti është dielli që i ndriçon mendjen e i ngroh zemrën, duke iu dhënë jetë fuqive shpirtërore.

ME DORËN BOSH

Thonë se Aleksandri i Madh kishte urdhëruar që kur të vdiste e ta varrosnin, dorën e djathtë t'ja linin jashtë varrit. Këtë gjë e bëri për të gjithë ata që me kureshtje do ta shihnin e do të pyesnin: Përse dora e mbretit ndodhej përjashta varrit? Atëherë duhej t'u përgjigjeshin: -Aleksandri me kaq pasuri e lavdi, asgjë nuk mundi të marri me vete në varr. Iku me duart bosh. Kështu ndodh, sepse njeriu i zhveshur vjen në këtë botë dhe i zhveshur do të largohet prej saj.

DUART E PERËNDISË

Kur isha i vogël, tregonte një jerond, shpeshherë nëna e mbushte grushtin me lajthi dhe i fshihte duart nga prapa. Të majtën apo të djathtën? - më pyeste. Të djathtën i thoja unë dhe ajo mbushte grushtin, duke më dhënë lajthitë e shijshme. Ajo e mbushte grushtin sërish dhe duke e fshehur përsëri më pyeste. –Të majtën nënë – i thoja unë, e kësaj here nëna hapte grushtin që ishte bosh. E njëjta gjë ndodh edhe me çdo të krishterë. Ne i kërkojmë Perëndisë me anën e lutjeve tona dhe Perëndia na e plotëson atë që i kërkojmë, jo kur duam ne, por sa herë dëshiron Perëndia. Duart e Perëndisë janë të mbushura gjithnjë me bekime, për ata që luten.

DIOGJENI DHE VERA

Njëherë, Diogjeni ishte i ftuar në një darkë. Atje, ndërmjet një menuje të pasur, i ofruan edhe një verë të zgjedhur. Diogjeni pasi e vështroi kupën e verës, e hodhi në dysheme. Kur e pyetën se përse e bëri këtë gjest, ai iu përgjigj: -Nëqoftëse do ta pija dëmi do të ishte edhe më i madh. Dikush duhej të dëmtohej e unë preferova të derdhja verën sesa të dëmtohesha vetë.

THESARET JANË TUAJAT

Gjatë një fushate luftrash që bëri Aleksandri i Madh në Lindje, caktoi një ushtar që ta ngarkonte gjithë floririn e grumbulluar në një mushkë. Thesari rëndonte aq shumë, sa që këmbët e mushkës dridheshin e nuk mund ta mbanin dot më. Atëherë, disa ushtarë u treguan të gatshëm për ta mbajtur pasurinë e çmuar në shpatullat e tyre. Aleksandri, duke parë zellin dhe gadishmërinë e tyre u prek thellë dhe u tha: -Kurajo trimat e mi! Të gjitha ato që mbani mbi supe u përkasin juve. E njëjta gjë ndodh edhe me çdo të krishterë, i cili mban mbi supet e tij problemet e jetës. Me të njëjtat fjalë i jep shpresë Krishti: -Kurajo trimat e mi! Thesaret e qiellit janë tuajat. Përpiquni me durim dhe do t' i fitoni.

MISTERI I RRËFIMIT

Një roje i pallatit mbretëror, dikur gjatë shërbimit hapi bllokun e shënimeve dhe vështronte atë faqe ku kishte shënuar të gjitha borxhet e tij. Pasi i mblodhi të gjitha, nën to shkruajti: “Mjerë unë si do të mund t’ i shlyej gjithë këto borxhe!” Atë çast ashtu siç qe i lodhur e zuri gjumi. Më pas kalon andej mbreti dhe e sheh ushtarin që po flinte me bllokun e hapur, tek borxhet e tij. Mbreti u prek dhe shkruajti dy fjalë: “Unë mbreti i shuaj të gjitha borxhet e tua”. Ushtari u zgjua dhe sa i madh ishte gëzimi i tij kur lexoi që mbreti i kishte shlyer gjithë borxhet e tij.

Çdo njeri ka mjaft borxhe. Janë mëkatet tona të përditshme. Por kemi edhe ne “Mbretin” tonë që i shlyen mëkatet tona. Nuk është aspak e vështirë. Mjafton vetëm të dëshirojë njeriu. Me misterin e rrëfimit shlyen të gjitha mëkatet.

KOSHI I FAJËSISË

Ava Amonas ishte njeri i virtytshëm e i shenjtë. Kur u bë episkop, të krishterët shkuan e i thonë se një murg kishte futur në qelinë e tij një grua mëkatare. Amonas e pranoi menjëherë akuzën dhe iu thotë atyre që ta ndiqnin pas. -Të shkojmë e të kontrollojmë, - ju tha. Murgu sapo i dëgjoi të afroreshin e fshehu menjëherë gruan mëkatare në një kosh. Kur mbërriti turma në qelinë e murgut, episkopi vajti menjëherë e u ul sipër koshit, për të mbuluar kështu fajin e murgut të tij. –Kërkoni! – i drejtua ai besimtarëve. E ata kërkuan kudo e nuk gjetën gjë. –Tani mund të shkoni – i drejtua më pas atyre. Kur të gjithë kishin ikur, ai e kapi dorën e murgut dhe i tha: -Kujdes shpirtin tënd o vëlla!

DITURIA E PAFUND

E pyetën njëherë Andonin e madh, se si ishte e mundur që, duke qenë krejtësisht i pashkolluar, të ishte kaq i urtë e i ditur, sa të këshillonte episkopët dhe mbretërit. Ai iu përgjigj: -Kam të dashurit e mi, një libër gjithnjë të hapur përpara meje. Faqet e para të tij janë toka me bimët, pemët dhe kafshët e panumërta. Në faqet që vijojnë është deti me shumëllojshmërinë e peshqve. Më tutje është qielli me yjet e tij, si dhe zogjtë e shumtë. Pra në këtë libër, unë munda të njoh diturinë e pafund të Perëndisë. Veprat e Tij flasin për këtë.

KAFSHONI GJUHËN

Thonë se dikur oratori i famshëm Dimosteni e kishte për zakon që ecte, duke tundur supin e djathtë. Veçse mundi ta mposhte këtë ves në këtë mënyrë: Vari disa thika të mprehta e kalonte nën to. Kështu nga frika se mos shpohej, u çlirua nga zakoni i keq. Këtë përpiquni të bëni edhe ju. Të kafshoni vazhdimisht gjuhën për çdo fjalë të keqe që nxirni nga goja, por në vend që të vendosni thika sipër saj, vini frikën e dënimit të Perëndisë dhe patjetër do të fitoni.

SHPËRBLIMI MË I MIRË

Njëherë një i ri, tepër i varfër kërkoi nga një njeri i ditur që të bëhet nxënësi i tij. –Çfarë do të më japësh si shpërblim? – e pyeti njeriu i ditur. Pasi u mendua pak, i riu iu përgjigj me vendosmëri: -Veten time.

PAULUTUR

A do të ishte e mundur që një piktor të pikturojë pa ngjyra?
Një shkrimtar të shkruajë pa penë? Një gdhendës të gdhendi pa
daltë dhe një ushtar të luftojë pa pushkë? E njëjta gjë ndodh me
çdo të krishterë, që mendon se mund të jetë i tillë pa u lutur.

NDERI DHE PARATË

Mbreti i Francës Karli VII (1403-1461) ishte shumë i drejtë
me shtetasit e tij. Njëherë, një vajzë e re i ankohet se një djalosh i
kishte marrë nderin me dhunë. Atëherë, mbreti e dënoi djaloshin
që t'i paguante vajzës 1000 monedha ari, si dëmshpërblim. Kur
po largoheshin, mbreti i thotë djaloshit që t'i vërsulet e t'ja marri
monedhat. Vajza u mbrojti me thonj e me dhëmbë për t'i ruajtur
monedhat. Kur ushtarët i sollën të dy, mbreti i tha vajzës: -Nëqoftëse
do të mbroje edhe nderin siç mbrojte monedhat e arit, nuk do ta
kishe humbur atë.

BASHKËPUNËTORË PERËNDIE

Aleksander Dyma u bë i famshëm me librin e tij “Zonja me Kamelie”. Shumë vetë atëherë besuan se në shkruarjen e kryeveprës e pati ndihmuar babai i tij. Na thoni të vërtetën, - e pyetën të atin, ç’ndihmë dhatë juve? – Sigurisht që kam bërë diçka iu përgjigj ai. Unë kam bërë shkrimtarin.

TË PYESIN PËRSE NUK EKZISTON

Udhëheqësi i Romës së lashtë Katon (234-149 para Krishtit) u shmangej gjithnjë nderimeve. Njëherë e pyetën disa miq te tij. – Të gjithë politikanët romakë e kanë statujën e tyre në pazarin e Romës. Përse juve nuk dëshironi që të vendoset edhe statuja juaj? E Katon iu përgjigj: - Preferoj që brezat që do të vijnë më mirë të pyesin përse nuk ekziston statuja ime, sesa përse ekziston.

ÇFARË PREFEROI

Aleksandri i Madh kur ishte adoleshent pa një ditë që nga bregu një varkë që rrezikohej nga dallgët e detit. Menjëherë urdhëroi ata që e shoqëronin për t'i shkuar në ndihmë. Por meqenëse asnjëri nuk guxonte të hipte në varkën e shpëtimit, ai hipi vetë i pari. E kur oborrtarët i treguan rrezikun që e kërcënonte, ai iu përgjigj: - Preferoj më mirë të bëhem pjestar i vdekjes së atyre njerëzve sesa të shoh atë skenë rrënqethëse.

MIKU I HYGOIT

Viktor Hygoi kishte një mik, i cili shkonte shpesh nëpër agripni, për të treguar shpresëtarinë e tij. Por gjatë ditës, në punën e tij nxirrte fitime të paligjshme. Atëherë, Hygoi i thotë një ditë: - Shpirti yt është si një Penellope, por me kuptimin e anasjelltë. Ndërsa mbretëresha e vjetër e Itakës, e shqepte gjatë natës pëlhurën, që kish thurrur gjithë ditën, ti e prish gjatë ditës atë që ke bërë natë.

PËLLUMBAT DHE BRETCKOKAT

Njëherë, Vasili i Madh tregonte: -Në bregun e një liqeni ishin ulur disa pëllumba. Pak më tutje, kërcenin përmbi ujë ca bretkoca. Një fëmijë hodhi një gur, atëherë, pëllumbat fluturuan dhe u ngjitën drejt qiellit, ndërsa bretkocat u zhytën thellë në ujë. Kësaj rrëfenje Vasili i Madh i jep këtë shpjegim: -Me goditjen e gurit nëqoftëse jemi fajtorë do të zhytemi, siç u zhytën bretkocat. Por nëse jemi të pastër, menjëherë do të ngrihemi lart, siç fluturuan pëllumbat.

DY RREMAT

Njëherë, një skocez kishte një varkë dhe transportonte udhëtarët përmes një liqeni të Skocisë. Ai kishte gdhendur tek të dy rremat fjalët: “Besim” dhe “Vepra”. Një udhëtar e pyeti se ç’kuptim kishin ato fjalë. Ai mori njerën rremë, ku ishte gdhendur fjala “Besim” e ia jep udhëtarit duke i thënë: Jepi varkës! Varka filloi të lëvizte, duke u anuar dhe duke u rrotulluar. Më pas, i thotë: Merre edhe rremën tjetër, atë ku është gdhendur fjala “Vepër” dhe jepi fort me të dyja. Atëherë, varka filloi të lëvizë shpejt dhe e sigurt. Pram nga kjo histori arrijmë në konkluzionin se: “Besimi pa Vepra nuk është asgjë”.

RIPËRTËRIHET

Thuhet, se shqiponja kur plaket, nuk mund të ushqehet dhe të shohë. Por ajo ka aftësi rigjenerimi. Për këtë ngjitet në një shkëmb të lartë dhe fërkon sqepin për ta mprehur. Më pas lahet në një liqen të ftohtë dhe pastaj qëndron në diell. Me këtë mënyrë rigjen përsëri shikimin dhe mund të ushqehet. E njëjta gjë ndodh edhe me të krishterin. Kur mëkaton ngjitet në lartësi që është ndërgjegjja dhe hidhet me forcë mbi shkëmbin e autokritikës. Më pas lahet në liqenin e lotëve të tij dhe pastaj ngrohet nga rezet e Shpirtit të Shenjtë. Në këtë mënyrë ripërtërihet si shqiponja, shpirti ynë.

PËR ÇDO ÇAST

Disa e vendosin Shkrimin e Shenjtë nëpër ikonastaset e tyre, duke shprehur shpresëtari. Disa të tjerë ia vënë fëmijës nën jastëk, me qëllim që ta ruajë. Kështu, Biblën duhet ta kemi kurdoherë pranë: -Kur kemi nevojë. -Kur na kap ankthi. -Kur besimi ynë lëkundet. -Kur jemi të frikësuar. -Kur kemi hidhërim. -Kur dyshojmë në shpagimin e pasioneve tona. -Kur ndjehemi të lodhur mendërisht.

KËNGA E ËMBËL

Në një stacion hekurudhor në Angli, dikur u përplasën dy trena. Ngjarja pati me qindra viktima dhe tronditi botën. Ndërmjet kufomave të përgjakura gjendej dhe një kafaz me një kanarinë brenda. Kanarina, duke mos e kuptuar mjedisin përreth filloi këngën e saj. Edhe sot, që njeriu jeton përmes dhimbjeve, dëshpërimeve e hidhërimeve e ka fuqinë për të dëgjuar këngën e besimit.

NDËSHKIMI I MËSUESIT

Njëherë, Diogjeni takoi në rrugë një vogëlush, i cili shoqërohej nga mësuesi i tij. Fëmija rrëmbeu një gur dhe e qëlloi Diogjenin. Filozofi në vend që të këshillonte fëmijën, qëlloi me shkop mësuesin, duke treguar me këtë mënyrë se kush e kishte fajin.

LUTJET DHE KRESHMA

Njëherë, në Antioki kishte rënë zija e bukës. Episkopi i Antiokisë Meleti u bëri thirrje të gjithë të pasurve për t'ua shpërndarë pasurinë të varfërve. Mjaft të pasur e bënë këtë. Veçse njëri prej tyre, që shquhej për hipokritin iu përgjigj se nuk kishte asgjë që të jepte përveç lutjeve të tij, për shpëtimin e qytetit. Atëherë, Meleti urdhëroi që t'ia merrnin me forcë të gjitha ushqimet që kishte fshehur në bodrumin e tij dhe i tha: -Tani do të zenë vend lutjet e tua, sepse do t'i bësh, duke kreshmuar.

HIPOKRIZIA

Shën Grigori i Nisës përmend këtë episod. Dikush kishte stërvitur një majmun të kërcente, duke u sjellë si njeri. E kishte veshur me rroba aristokrati dhe i kishte vënë maskë. Të gjithë që e shihnin mendonin se qe një fëmijë i vogël që vallzonte. Një spektator deshi ta vinte në provë. Ai i hodhi disa banane e majmuni menjherë e ndërpreu kërcimin dhe duke e shqyer maskën filloi të hantë në një cep të skenës. Shën Grigori thotë: “Kështu ndodh edhe me hipokritët, të cilëve sapo ju paraqitet ndonjë interes, heqin maskën dhe veprojnë si kafsha”.

PESHA E PROVËS

Një i krishterë kishte gruan e tij të sëmurë rëndë dhe vajzën e paralizuar. Një ditë hyri në shtëpi me një pako të madhe, dhuratë për ditëlindjen e gruas. Vajza që qëndronte në karrocën e saj, sapo e pa i thotë: -Do t'ja shpie unë nënës dhuratën. –Po si do të mund t;ja shpiesh bija ime! Ti nuk mundesh – tha babai me zemër të lënduar. –Ja baba, - thotë vajza. Unë do ta mbaj pakon në duart e mia dhe ti do të më mbash mua në krahët e tu. E njëjta gjë ndodh edhe me mua, unë mbaj peshën e fatkeqësisë sime dhe Krishti më mban mua.

SHKAKU I MOSBESIMIT

Njëherë, një misionar u fliste disa fiseve të egra për ngjalljen e të vdekurve dhe për gjykimin e fundit. Të gjithë e dëgjonin të mrekulluar. Kryetari i tyre u çudit aq shumë, saqë filloi të pyeste: “Si do të ngjallen? A do të ngjallen të gjithë? Dhe misionari ia shpjegoi. Atëherë, njeriu i egër i thotë: Këtë nuk dua ta besoj, sepse nëse ngjallen të gjithë ata që kam therrur, mjerë unë ku do të futem!!!

KJO KA VLERË

Dikur shkrimtari i njohur Dickens tha: -Mos e vlerëso kurrë njeriun nga rrobat, sepse ato ia ka qepur rrobaqepësi. Mos e vlerëso nga origjina, sepse edhe Kaini e kishte origjinën nga familja e parë e botës. Mos e vlerëso nga banesa e tij, sepse edhe milingonat e buburrecat banojnë nëpër pallate madhështore. Duhet ta vlerësoni nga ajo që bën. Diçka që nuk ia kanë bërë të tjerët dhe nuk mund ta imitojë lehtë njeri.

ME NJË VESH

Një nga oborrtarët iu afrua Aleksandrit të madh dhe filloi t' i pëshpëriste në vesh për një person. Mbreti e mbylli me pëllëmbë veshin tjetër. Kur shpifësi e pyeti përse e bëre këtë, ai iu përgjigj: “Të dëgjova me kujdes, por me njerin vesh ama, ndërsa me veshin tjetër dëgjoja atë që akuzon, sepse ashtu si zogjtë që lakmojnë frutat e pjekura, edhe shpifësat lakmojnë njerëzit e virtytshëm e me vlerë.

TAKOHEN RRALLË

Njëherë, politikani francez Brian (1862-1932) i ftuar në një ekspozitë, shihte me interes pikturat dhe qëndroi përpara një tabloje ku paraqiteshin dy gra, duke u përqaftuar. Piktori deshi ta sqaronte se ç'paraqiste ajo tablo dhe i thotë: Është një paraqitje alegorike, ku simbolizohen *mirëbërja* dhe *mirënjohja*. –E kuptoj, u përgjigj Brian, përqafohen të shkretat, sepse takohen rrallë.

MBAS SHKREPËTIMAVE FILLON SHIU

Njëherë, Sokrati bënte fjalë me gruan e tij, Ksanthipin. Sokrati, për të shmangur sherrin deshi të largohej, duke zbritur shkallët me vrap. Ksanthipi u nxeh më tepër, rrëmbeu një kovë me ujë dhe u vërsul drejt dritares, duke e derdhur në kokën e të shoqit që po kalonte nën dritare. Soktari, megjithëse i bërë qull nuk e humbi gjakftohtësinë. –E prisja, që mbas shkrepëtimave do të fillonte shiu, - tha dhe u largua.

ATA QË KËRKOJNË LAVDI

Perandori i Brazilit Don Perdo (1822-1831) i shiti gjithë titujt e lartë të Perandorisë për dhjetë mijë dollarë. Mjaft pasanikë u vërsulën të blejnë titujt. Me paratë e grumbulluara Don Pedro ndërtoi një çmendenë, ku në hyrje të saj shkruajti: “Ata që kërkojnë lavdi ua ndërtojnë të çmendurve”.

MADHËSHTIA E DASHURISË

Mbreti i Skocisë, Jakovi II, pyeti njëherë një kryengritës, që ia sollën përpara: “E dini se është në dorën time t’ju dënoj”? Dhe kryengritësi iu përgjigj: “Po, është në dorën tuaj, por nuk është në natyrën tuaj, Madhëri!”. Pikërisht, në natyrën e madhështisë së Perëndisë e në dashurinë e Tij jemi ne sa herë biem në mëkat dhe jemi të bindur se ai na fal vetëm pasi pendohemi.

SHEMBULLI I PRINDËRVE

Një baba këshillonte birin e tij, që nuk mësonte dhe me ato rezultate që kishte nuk do të mund të bëhej i zoti në jetë. –Je tetëmbëdhjetë vjeç, - thoshte, e s’je për asgjë. –A e di ti, se Napoleon Bonaparti në moshën tënde filloi fushatat luftarake? – Ndërsa në moshën tënde u bë perandor, iu përgjigj i biri.

MEGJITHËSE NA NJEH

Një ditë tek filozofi Antiztheu u paraqit një njeri, i cili kërkonte borxhe e nuk i kthente më. –Erdha të kërkoj dyqind lira –i thotë ai filozofit. E filozofi iu përgjigj: -Të njoh mirë se kush je, por megjithatë do t’i jap paratë që më kërkove borxh. Të njëjtën gjë bën edhe Perëndia me ne. Megjithëse na njeh mirë se kush jemi, na i plotëson kërkesat tona.

MË E MIRA DHE MË E KEQJA

Kur Ezopi ishte skllav, zotëria i tij e dërgoi një ditë në Pazar për të blerë ushqimin më të mirë. Ezopi bleu gjuhë. Kur zotëria e pyeti për se zgjodhi gjuhët si ushqimin më të mirë ai iu përgjigj: - Sepse nuk ekziston gjë më e mirë se gjuha. Me gjuhën lutemi dhe themi të vërtetën. Mirë i tha zotëria, nesër do të më psonisësh ushqimin më të keq, që do të gjesh në treg. Ezopi i solli përsëri gjuhë. Dhe kur zotëria e pyeti përsëri, ai iu përgjigj: -Gjuha është më e keqja nga të gjitha, sepse gjuha shan, blesfemon dhe nuk thotë të vërtetën.

TË MENDOHEMI

Oratori i vjetër Foqion e kishte zakon të mendohej shumë përpara se të fliste. Njëherë e pyetën: “Përse mendohesh kaq shumë”. Ai iu përgjigj: -Sepse dua të mendoj, se mos duhet të heq nga ato që kam për të thënë diçka që nuk është e vërtetë. Ne të krishterët, vallë a duhet të mendohe mi përpara se të flasim? Të kemi kujdes që me fjalët tona të mos fyejmë shokët tanë.

KUNDËRSHTARI

Thonë, se njëherë mbretëresha e asirëve Semiramida i kërkoi mbretit që në shenjë dashurie t'ia dhuronte mbretërinë vetëm për njëzetekatër orë. Mbreti mëndjehetë, nga fjalët e bukura që i thoshte mbretëresha pranoi, duke nënshkruar dekretin mbretëror, me të cilin i jepte asaj të drejtën që të mbretëronte për njëzetekatër orë. Pra, i gjithë populli dhe ushtria për këto nëzetekatër orë duhej t'i nënshtroheshin urdhrave të mbretëreshës.

Sapo mori mbretërinë, Semiramida, urdhri i parë që dha ishte të kapej mbreti. E pas kësaj vazhdoi menjëherë edhe urdhri i dytë t'i pritej koka. Me të njejtën mënyrë vepron edhe djalli. E merr njeriun me të mira derisa ta shpjeri drejt mëkatit. Mjerë, ata që do ta nënshkruajnë marrëveshjen me djallin, sepse do të gjejnë vdekjen.

NË SHËRBIM TË MBRETËRISË

Njëherë, një mik i shpikësit Edison vajti ta vizitonte në shtëpinë e tij. Sapo u takuan, miku i thotë: -Zoti Edison, u lodha shumë duke hapur portën tuaj. Nuk i hedh pak vaj që të lëvizi më lehtë. -Kjo gjë që më kërkoni nuk mund të bëhet - iu përgjigj Edisoni. Pa shih atë pompën atje. Çdo herë që hapet porta nxjerr nga pusi rreth njëqin litra ujë, për të vaditur kopshtin tim.

ORIGJINA

Njëherë, shkrimtari i librit “Udhëtimet e Guliverit”, Suit (1667-1745) takon një mikun e tij. Ky i fundit filloi të mburrej rreth bëmave të gjyshit e të stërgjyshit të tij. Atëherë, Suit iu përgjigj: - Ata që mundohen të marrin lavdi nga bëmat e të parëve të tyre, ngjajnë me patatet. Siç e dimë pjesa më me vlerë e patates gjendet thellë në tokë, e mbuluar me dhe, ndërsa sipër dheut gjenden fletët e gjelbëra e pavlerë.

PUNA E MURGUT

Murgu Isirio ndjehej mjaft i lodhur. Kur e pyeti Igumeni se nga i vinte lodhja, ai iu përgjigj: Kam shumë punë gjatë ditës. Kam dy pleq që duhet të kujdesem, kam dy langonj që duhet t’i stërvis, një dragua që duhet ta ruaj, një luan që edhe me atë duhet të ndeshem çdo ditë, dhe një të sëmurë që duhet të kujdesem. Igumeni u çudit dhe e pyeti: -Ç’ do të thuash me gjithë këto? –Dy pleqtë janë sytë e mi. Duhet t’i ruaj për të mos parë asgjë, që do të më dëmtojnë. Dy langonjtë janë këmbët e mia. Duhet t’i mbaj me qëllim që të mos marrin udhën e mëkatit. Dragoi është gjuha ime, të cilën mundohem ta mbaj të lidhur. Luani është zemra ime, me të cilën ndeshem shpesh dhe i sëmuri është trupi im, të cilin duhet ta kuroj e ta ruaj, sepse në të banon shpirti im.

THESARET E FSHEHUR

Ezopi përmend se na ishte njëherë një bujk, i cili para se të vdiste i këshilloi fëmijët që ta punonin mirë vreshtin, sepse atje kishte fshahur thesarin. Djemtë e zbatuan porosinë e babait të tyre. Gërmuan e zbatuan porosinë e babait të tyre. Gërmuan thellë, duke e punuar vreshtin, por nuk e gjetën atë që kërkonin. Veçse vreshti ju dha prodhim të bollshëm. Diçka e ngjashme ndodh edhe me thesaret shpirtërore. Ata janë të fshehur në thellësitë e shpirtit. Sa më thellë të gërmosh në vreshtin e shpirtit tënd, aq më prodhim të bollshëm do të japi ai.

ILAÇI MË I MIRË

Dikur muzikanti Jozef Haid fliste me dy miqtë e tij për dhimbjet, provat e hidhërimet e jetës. Unë, - thotë i pari, - kur jam i dëshpëruar e hedh hidhërimin në gotën e verës. Ndërsa unë, - thotë tjetri, - filloj të luaj muzikë në piano. Kurse Jozef Haid, u përgjigj: -Unë, kur jam i mërzhitur shkoj diku në vetmi, gjuhëzohem dhe i lutem Perëndisë. Ja them dhimbjen time dhe kam një komunikim ngushëllues në të.

UNË NUK JAM ASGJË

Njëherë, në Indi ndodhi që një fshirës rrugësh i krishterë të predikonte. Rreth tij grumbulloheshin mjaft njerëz, duke e dëgjuar me endje. Një ditë, një zotëri iu afrua dhe i thotë: Nuk mund ta kuptoj, se ç' mundt të dëgjojnë gjithë ata njerëz nga një fshirës rrugësh. Ai, iu përgjigj: -Sigurisht, që unë nuk jam asgjë, e këtë ua them shpesh atyre që më dëgjojnë, por u them të ndjekin Krishtin, sepse mbretëria e Tij nuk do të ketë mbarim.

RILINDJE

Një shenjtor thoshte: -Tri herë lind njeriu. –Një herë kur vjen në jetë nga barku i nënës. –Kur del nga kolimvithra e pagëzimit. –Nga lotët e pendimit. E para dhe e dyta e sjellin njeriun nga toka në tokë. Ndërsa e treta e rilind, duke e ngritur nga toka në qiell.

SHPATA E SHKURTËR

Njëherë, një spartane i jep të birit të saj të mitur një shpatë, në çastin që ai po nisej për të luftuar bashkë me të rriturit. I biri, sapo e pa shpatën filloi të ankohej se ishte e shkurtër. S'ka gjë, - i thotë e ëma. –Do të duhet të bësh ti një hap përpara. Guximi e plotëson mungesën e mjetit.

NJË HAP PËRPARA OSE PRAPA

Dikur një shkrimtar i ri, ia lexoi veprën e tij Viktor Hygoit, i cili i tha: - Ju dëgjova me vëmendje. Me këtë vepër letërsia bën një hap të madh. -O ju faleminderit, - thotë i riu i kënaqur. Hygoi e vështroi dhe e pyeti: -Përse duhet të më falenderoni? Unë nuk ju thashë se ai hap u bë përpara apo mbrapa. Kështu ndodh edhe në jetë. Çdo vepër e jona është një hap përpara ose prapa.

TRI MËNYRAT E TË JETUARIT

Ekzistojnë tri mënyra, me të cilat njerëzit e shijojnë jetën. Shumë e shohin jetën si një krevat qetësues, në të cilin çlodhen dhe presin që t'ju shërbejnë të tjerët, por shumë shpejt e kuptojnë këta njerëz, që krevati i jetës nuk ishte aq i rehatshëm sa ç'e mendonin, prandaj përpëliten me ankth. Disa të tjerë e shohin jetën si një kosh të madh dhe përpiqen ta mbushi atë me çdo mënyrë, me njohuri, para, famë dhe lavdi. Këta janë materialistë. Megjithatë, koshi i tyre nuk mbushet asnjëherë, ndërsa ata vrapojnë e enden kot. Por ekziston edhe një pjesë tjetër njerëzish, që e konsiderojnë jetën e tyre si një lambadhë, e cila shkrihet e ndriçon mjedisin rreth tyre. Këta janë të krishterët, të cilët janë gati të sakrifikohen të ngushëllojnë çdo dhimbje dhe të qetësojnë zemrat e lënduara.

TË KUJDESENI

Njëherë, një shenjtor duke predikuar u thotë të krishterëve, që kishin ndihmuar në ndërtimin e kishës. –A e dini vallë se ç'u bë me ata që ndërtuan varkën e Noes. –Jo, -iu përgjigjën ata. –Po ua them atëhere. Ata nuk hynë në varkën e shpëtimit, sepse ishin mëkatarë dhe u zhdukën mbas kataklizmës. Kujdes edhe juve, megjithëse ndihmuat në ndërtimin e kishës, të kujdeseni edhe për kishën e vogël që ndodhet në shpirtin tuaj.

LIBRI MË I ÇMUAR

Një armik i mbretit Mithridhati kishte shkruar një libër kundër tij, në të cilin përmendeshin gjithë dobësitë e mbretit. Mithridhati e lexoi librin me kujdes dhe e vlerësoi si gjënë më të çmuar. Shpesh thoshte: -Ky libër është miku im më i mirë, sepse më thotë dobësitë e mia dhe ato gjëra që askush nuk pati guximin të mi vinte në dukje.

LAVDIA

E pyetën dikur Diogjenin: -Në cilën moshë është më e përshtatshme të marrësh kurorën e lavdisë? E filozofi iu përgjigj: - Në asnjë moshë. Për të rinjtë është tepër herët që të shijojnë kënaqësitë e lavdisë, ndërsa për të moshuarit është tepër vonë.

DY BABALLARËT

E pyetën njëherë perandoreshën Theodhora, përse e respektonte më shumë atin shpirtëror Joanikin më tepër se babain e saj. Ajo me lotë në sy iu përgjigj: -Sepse babai im, duke më sjellë mua në jetë, më bëri të zbres nga qielli në tokë, ndërsa ati shpirtëror Joaniki me këshillat dhe me shembullin e tij, më bëri që të ngjitem nga toka në qiell.

E VËRTETA

Mbi anijen që quhet tokë dhe që udhëton drejt pafundësisë e cim ne, duke mërguar. Të gjithë ëndërrojmë të gjejmë një breg. Është pikërisht bregu i atij vendi, ku era është e ëmbël dhe asgjë nuk fshihet. Këtë vend e kërkojmë prej kohësh dhe *quhet e vërteta*. Sa të lumtur do të jemi nëse i qëndrojmë besnikë deri në fund të vërtetës.

BUKURIA

Njëherë e pyetën një vajzë të krishterë, se çfarë përdorte për zbukurim. Ajo iu përgjigj: Për buzët e mia përdor të vërtetën. Për fytyrën time çiltërsinë e dashurisë. Për duart e mia përdor lëmshën. Për këmbët kujdesem të mos shkel aty ku s' duhet. Për flokët e mi përdor lotët e pendimit... Këto duhet të jenë stolitë e çdo të krishteri.

VETËM DY KATEGORI

Kur zuri kataklizma ekzistonin dy grupe njerëzish. Ata që qenë brenda në arkën e Noes dhe ata që qenë jashtë. Gjithashtu, dy kategori përmenden edhe në paravolinë e rrjetës: – Peshq të mirë dhe peshq pa vlerë. Dy kategori përmenden në paravolinë e dhjetë virgjëreshave, ato të gatshmet dhe ato dembelet. Dy kategori njerëzish do të ekzistojnë në çastin e gjykimit; delet dhe dhitë. Dy vende do të ketë në fronin e gjykimit të Birit të Njeriut. Ata që do të rrinë në të djathtë e në të majtë. Dy gjendje do të jenë në gjykimin e fundit, mbretëria e qiejve dhe ferri. Në cilën kategori bën pjesë ti?

DO T’I SHOHI PERËNDIA

Një gurgdhendës punonte në majën më të lartë të një kishe, duke skalitur pllloçat e çatisë. Dikush i thotë: -Përse lodhesh kaq shumë? Ato nuk do t’i shohi askush! Por gurëgdhendësi iu përgjigj: -I skalit bukur dhe me merak, sepse do t’i shohi Perëndia. Për të punoj! Sa i dobishëm është ky mendim për çdo besimtar.

VETËM SHPRESA

Aleksandri i Madh para se të nisej për një fushatë luftarake në Azi, ua shpërndau gjithë pasurinë oficerëve të tij. –Po për juve çfarë ngeli? – e pyeti miku i tij më i ngushtë, Perdhika. –Vetëm shpresa, - iu përgjigj Aleksandri. Çdo i krishterë, duke filluar marshimin për në jetën e përjetshme nuk duhet të dëshpërohet për ato që ka humbur në këtë jetë, por nuk duhet të humbi shpresën se do ta presin gjëra më të çmuara në mbretërinë e qiejve.

SEKRETI I SUKSESIT

Njëherë, te poeti i madh Sofokliu u paraqit një politikan athinas për t'i treguar disa poezi të tijat. –Këto i kam shkruar gjatë orëve që nuk kisha se ç'të bëja, - thotë ai. Sofokliu e pa njëherë në sy dhe iu përgjigj: -Pa më thoni se ç'mendim do të kishit juve nëqoftëse unë do të qeverisja Athinën në kohën kur nuk kisha ndonjë punë për të bërë? Dëshiron, pra të bësh diçka të bukur dhe të vërtetë në jetën tënde? Përkushtoj me gjithë fuqitë e tua dhe do t'ia arrish patjetër!

GJYKATËSI

Njëherë, një gjykatës duhej të dënonte një mikun e tij të fëmijërisë. Ai e dënoi atë që të paguante një shumë të madhe parash. Sigurisht që i dënuari nuk kishte t'i paguante kaq shumë para. Atëherë, gjykatësi vendosi të paguante nga paratë e veta. Të njejtnë gjë bën edhe gjykatësi i drejtë, Perëndia. Pagan ai borxhet e mëkatarëve. Ai është shlyesi për mëkatet dhe jo vetëm për mëkatet tona, por për të gjithë botës.

DIAMANTET

Tregojnë se princesha e Suedisë, Evgjenia themeloi dikur një spital. Paratë që pati vënë në dispozicion nuk mjaftonin. Atëherë, ajo u detyrua që të shiste diamantet e saj. Kur përfundoi spitali, ajo shpesh vizitonte të sëmurët. Një ditë dëgjoji që po qante një i sëmurë. Ajo, menjëherë e pyeti se ç' kishte. I sëmuri qante nga mirënjohja për princeshën, e cila kishte ndërtuar spitalin për të lehtësuar barrën e sëmundjes së tij. Atëherë, princesha e mallëngjyer thellë nga lotët e të sëmurit, tha: -Të gjitha diamantet që shita i gjeta përsëri.

LUTJA E PËRDITËSHME

Gamilja gjunjëzohet në mbrëmje që ta shkarkojnë nga ngarkesa. Gjithashtu gjunjëzohet edhe në mëngjes për të pranuar ngarkesën mbi shpinën e saj. Kështu edhe ne duhet të gjunjëzohemi në mëngjes dhe në mbrëmje, duke iu lutur Perëndisë.

DHURATA MBRETËRORE

Njëherë, një lypsar i quajtur Lekios i kërkoi lëmoshë Aleksandrit të Madh, dhe ky i fundit i tha se i dhuronte një qytet të tërë. Njeriu i varfër mendonte se mbreti tallej me të. Por Aleksandri i tha: -Jo Lekio, të kam thënë të vërtetën! Mos mendo kurrë se cili je ti që kërkon, por cili është ai që të jep dhuratën. Kështu duhet të veprojmë edhe ne të krishterët. Le të kërkojmë me besim hirin e Perëndisë. Ndonjëherë edhe mund të zhgënjehemi, por Perëndia do t' u përgjigjet lutjeve tona me dhurata të panumërta.

TI NUK QAN

Në një muze ikonografie ekziston një ikonë ku paraqitet mbreti David, duke qarë për mëkatin që bëri, duke marrë gruan e Urias, mbasi e çoi këtë të fundit të vritet në luftë. Pranë tij gjendet një engjëll që mbledh lotët në një vazo të kristaltë dhe i dorëzon tek Perëndia. Nën ikonë një atë i kishës ka shkruar: -Davidi mëkatoi vetëm një herë dhe qau gjithë jetën që i pati mbetur, ndërsa ti ke mëkatuar shumë herë dhe nuk ke qarë kurrë.

NJERIU DHE KAFSHA

Një aristokrat athinas godiste me kamzhik kalin e tij, sepse nuk donte të ecte. Atë çast mbërriti aty pranë filozofi Spevsipi dhe i thotë: -Mjaft me inat, tregoje që je një qenie e zgjuar dhe që bindesh!.... –Si guxon të më thuash këto fjalë? –i thotë pronari i kalit, gjithë inat. –E keni gabim! –iu përgjigj filozofi. Unë nuk fola me juve, por me kafshën tuaj.

I GJEJ BRENDË MEJE

Predikatoti francez Masigion (1661-1742), nëpër bisedat e tij përshkruante aq bukur pasionet njerëzore. Njëherë e pyetën: -Atë, si është e mundur që juve një murg që nuk keni aspak përvojë nga e keqja njerëzore të njihni kaq mirë pasionet? Predikatori iu përgjigj: -I gjej ato brenda meje. Pak sa të gërmoj në zemrën time, ndeshem me mijëra pasione të këqija.

VIRTYTI I PËRJETËSISË

Apostull Pavli shkruan se tre janë virtytet e mëdha të krishterimit. Besimi, Shpresa dhe Dashuria. Nga këto, kjo e fundit është virtyti më i madh. Ndërsa dy të parat duhen vetëm në këtë botë, e tretat ngelet edhe në jetën tjetër. Me të vëretë kur të gjendemi në Mbretërinë e Perëndisë nuk do të besojmë më, sepse do ta shohim Zotin ballë për ballë. Nuk do të shpresojmë më, sepse do të kemi marrë të gjitha të mirat, që na kishte premtuar Zoti. Vetëm do të dashurojmë.

ZEMRA E NËNËS

Njëherë, një djalë donte të hynte në një shoqëri keqbërësish. Ata nuk e pranuan menjëherë. Duam të të provojmë, - i thonë. A mundesh të na e sjellësh këtu zemrën e nënës tënde? Djaloshi i hipi kalit e vajti në shtëpi. Nëna e tij po flinte. Ai mori thikën dhe ia nxori zemrën. Me zemrën e nënës në dorë i hipi përsëri kalit dhe vazhdoi udhën, për të shkuar tek keqbërësit. Gjatë udhës ai u rrëzua nga kali. Gjithashtu i ra edhe zemra e nënës nga dora. Ashtu siç që i dërmuar dëgjoi zemrën e nënës t'i thoshte me dhembshuri: -A u vrave, biri im?

TABLOJA DHE SHTËPIA

Një i pasur porositi tek Leonardo da Vinçi një tablo. Pasi i dha porosinë e ftoi në shtëpinë e tij për t'i treguar dhomën, ku do të vendoste tablonë. –Duke parë dhomën i tha që t'i kombinonte ngjyrat që do të pikturonte me ambjentin e saj. Leonardo da Vinçi iu përgjigj: -Lermë mua të bëj tablonë e më pas rregulloje dhomën si të duash ti.

DASHURIA E ENEAS

Kur grekët fituan mbi trojanët, i urdhëruan banorët të braktisnin shtëpitë e tyre, pasi të kishin marrë nga to vetëm një send. Enea, i biri i mbretit të Trojës mori një statujë të perëndisë që mbronte shtëpinë e tij. Grekët e pëlqyen shprestarinë e tij dhe për këtë e lejuan që të merrte edhe diçka tjetër. Kur ai hyri për herën e dytë në shtëpi, e panë të dilte, duke mbajtur mbi shpatulla babanë e tij të plakur....

Pa mendoni! Një prijës që jetonte mbrenda errësirës idhujtare e gjeti rastin për ta shfaqur besimin e tij te Perëndia, si dhe dashurinë dhe respektin për babanë. Pa pyesni veten njëherë: Çfarë do të thoshte Enea nëqoftëse do të jetonte në epokën e sotme dhe të shihte të rinjtë duke përbuzur Perëndinë dhe prindërit e tyre? Turp pra për ata, që duke pasur me mijëra drita, akoma veprojnë si të verbër.

PËRPARA SE TË NA KËRKOJË

Muzikanti me famë Wagner i kaloi vitet e fëmijërisë së tij, përmes një varfërie të madhe. Njëhere, ai po shëtiste me një mikun e tij aristokrat nëpër rrugët e Mynihut. Menjëherë sytë e Vagnerit përqëndrohen tek një djalosh që po e vështronte me admirim. Vagneri i mësuar tashmë të lexonte dëshitrat në vështrimet e njerëzve, zgjati dorën duke i dhënë një monedhë të florinjte. Miku i tij aristokrat u çudit dhe e pyeti: - Përse e bëre këtë bamirësi? Djaloshi nuk të kërkoi para. Vagneri iu përgjigj: - Sepse vetëm ai që e ka shijuar skamjen dhe varfërinë mund të lexojë përmes shikimeve të njerëzve, atë që ata kërkojnë.

HIJA E GOMARIT

Oratori i famshëm Demosteni u fliste dikur athinasve për çështje e probleme të rëndësishme, mirëpo athinasit nuk tregonin interesim. Atëherë, oratori e kuptoi dhe filloi të tregonte një anekdotë: “Dikur dy athinas u zunë për hijen e një gomari. Njeri ishte pronari i gomarit, ndërsa tjetri e kishte marrë atë me qera. Duke ecur nëpër vapën e gushtit, qiraxhiu kishte hipur në gomar, ndërsa i zoti e godiste me shkop nga pas që të ecte. Diku nga mesi i udhës vendosën të pushonin. Vendi ishte i shkretë dhe dielli përvëlonte. Nuk kishte vend me hije, përveç hijes që lëshonte gomari.

Për këtë filluan të zihen, se kush do të qëndronte në hije. I zoti i thoshte: “Unë të kam dhënë me qera gomarin e jo hijen e tij”. Kështu, sherri mori përmasa të mëdha. Demosteni bëri një pauzë të vogël. Athinasit, duke e dëgjuar me vëmendje, më pas e pyetën njëzëri: -Po më pas ç’u bë? Kush qëndroi në hijen e gomarit? Atëherë, Demosteni iu kthye atyre me një zë të rreptë: -Për hijen e gomarit tregoni interes, ndërsa për çështjet e mëdha që na preokupojnë qëndroni indiferentë!

Ky është fakt. Mos vallë edhe ne shpesh bëjmë të njejtën gjë? E kemi mendjen tek çikërimat e gjërat e parëndësishme e nuk tregojmë interes për gjërat e mëdha.

Ç'KËRKON I RËNURI

Njëherë, një kalimtar nga pakujdesia bie në një pusëtë të thellë. Një njeri që po kalonte e pa dhe i erdhi keq. Hapi çantën e tij dhe i hodhi një shishe me aromë. -Këtë kam të të jap. Kur ta ndjesh të nevojshme të aromatisesh. Një kalimtar tjetër i hodhi një franxhollë. Kur të kesh uri, të hash, - i tha duke ikur. Më pas kaloi një kalimtar tjetër, i cili duke e parë në atë gjendje filloi ta këshillonte: -Nuk i pate sytë në ballë?

Diçka e ngjashme ndodh edhe me rënien e gjinisë njerëzore. Njeriut të rënë në grackën e mëkatit, askush nuk mund t' i japë atë që dëshiron. Asnjë nuk mundi t' i thoshte: Eja unë do të të nxjerr nga gracka e mëkatit. Por këtë gjë vetëm Krishti mund që ta bëjë. Nëse je sëmurë, Ai të shëron. Nëse je mëkatar Ai të jep faljen e mëkateve. Nëse ke humbur në errësirën e mëkatit, të jep dritën e Tij, që të gjesh rrugën e vërtetë të jetës.

KOMPOZITORËT E MËDHENJ

Disa nga kompozitorët më të mëdhenj e kishin origjinën nga familje me shumë fëmijë. Bahu ishte fëmija i 8-të, Moxarti që i 7-ti, Hendel ishte i 10-ti, Vagner që i 9-ti, Haid ishte i 120-ti dhe Shubert bënte pjesë në një familje me 14 fëmijë. Familjet me shumë fëmijë gjithnjë grumbullojnë bekimet e Perëndisë. Brenda tyre Perëndia zgjedh ata që do t' i psalin krijesave madhështore të tij.

DHE ME PERËNDINË DHE ME DJALLIN

Një ditë, një plak hyri në një kishë dhe mori dy qirinj. Njerin e ndezi përpara ikonës së Krishtit, ndërsa tjetrin e mori me vete. Neokori që e pa, nga kureshtja e pyeti: -Përse nuk e ndeze edhe qiriun tjetër? –Këtë do ta marr në shtëpi dhe do t’ia ndez djallit. E bëj këtë, sepse nuk jam edhe aq i sigurt, nëse do të shkoj në Parajsë. Pra nëqoftëse vete në ferr, mirë do të jetë të kem marrë me të mirë edhe të ligun. Ndoshta do të më duhet.

Padyshim, ne e dënojmë aktin e plakut. Mos vallë edhe ne bëjmë të njëjtën gjë? Me njerën dorë ndezim qiriun tek ikona e Krishtit e me dorën tjetër tek djalli? Me njerën këmbë ecim në udhën e Perëndisë dhe me tjetrën në atë të djallit? Me njerin sy shohim qiellin e me syrin tjetër ferrin.

PËRULËSIA

Njëherë, mbreti i Spartës Agisilaos vajti në teatër. Duke kërkuar vendin ulet në një karrige të thjeshtë. Punonjësit që merreshin me vendosjen e spektatorëve, sapo e panë vajtën e i kërkuan falje sepse nuk ishte ulur në fronin mbretëror. –Mos u shqetësoni! – u thotë ai, nuk janë vendet ato që nderojnë njerëzit, por spektatorët i nderojnë ato vende. Është fakt se as gradat e as ofiqet nuk i japin vlerë njeriut, por njeriu me veprat e tij i rrit vlerat përpara të tjerëve. Përrulësia është ajo që na rrit më tepër nga sa vlejme.

FILOZOFI DHE PESHKATARI

Njëherë, një filozof donte të kalonte në bregun tjetër të liqenit. Ai hipi në varkën e një peshkatari. Duke u dhënë rremave, filozofi e pyeti: -Pa më thoni, a merrni ndopak vesh nga filozofia? – Jo – iu përgjigj peshkatari. Që i vogël nuk e pata mundësinë për të vajtur në shkollë, sepse ngela jetim e u detyrova të nxjerr bukën e gojës. –Keni bërë gabimin më të madh që nuk e njihni filozofinë – i thotë filozofi. Të mos njohësh filozofinë është njësoj si të kesh humbur gjysmën e jetës.

Kur arritën në mesin e liqenit, një furtunë e fortë filloi ta përplaste varkën. Atëherë, filozofi u drejtua nga peshkatari dhe i thotë: -Më thuaj ç' duhet të bëjmë? –Të hidhemi e të notojmë – i thotë peshkatari. –Por unë nuk di të notoj – përgjigjet filozofi. – Atëherë ç' ke bërë në rininë tënde? –i thotë peshkatari. –Kam studiuar e nuk kam pasur kohë të mësoj notin. –Atëherë keni humbur gjithë jetën tuaj – i tha peshkatari. Ky është një mësim i mirë për ata që merren me gjëra të rëndësishme e nuk u kushtojnë vëmendje gjërave të vogla. Por, ndonjëherë humbasin gjithshka.

MË MJAFTON VETËM T’JU SHOH

Tre jerondë shkonin një herë në vit tek Ava Andoni, për të mësuar nga Oshënari i Madh. Dy prej tyre i bënë pyetje të ndryshme rreth ushtrimit të shpirtit dhe të trupit. Kështu edhe Oshënari u përgjigjej me fjalët e tij të mençura. I treti dëgjonte gjithmonë i heshtur dhe pa bërë asnjë pyetje. Njëherë e pyeti Oshënari: -Vëlla, keni kaç vjet që më vizitoni dhe kurrë nuk më keni bërë pyetje. Nuk dëshiron të mësosh ndonjë gjë? –Më mjafton vetëm t’ju shoh Ava, - iu përgjigj ai.

EDHE UNË JAM I KRISHTERË

Tradita thotë se apostull Jakovi, vëllai i Ungjillorit Joan, në çastin që po e shpinin për t’u martirizuar, takon në rrugë atë që e kishte tradhëtuar. E ndaloi dhe e puthi, duke i thënë: -Paqe mbi ty, vëlla! Ky i fundit, duke parë këtë gjest u mrekullua dhe thërriti me entuzjazzëm: -Që sot edhe unë jam i krishterë. Mbas këtij pohimi ju pre koka edhe atij, së bashku me apostullin.

LER ATË QË T'JU GATUAJMË DIÇKA

Njëherë, një jerond donte të provonte murgjit e një skiti. Hyri në kopshtin e tyre dhe me shkop në dorë filloi të shkatërronte një nga një të gjitha lakrat që kishin mbjellë. Murgjit e panë, por nuk i thanë gjë. Kur kishte mbetur vetëm një lakër dhe kur jerondi u bë gati për ta goditur edhe atë, del përjashta murgu më i ri dhe i thotë me shumë respekt: -I bekuar Jerond! Lere atë që të gatuajmë diçka, për t' u mikpritur sonte!

FALENDERIM NDAJ PERËNDISË

Historiani rus Karamzin, në vitet e rinisë, jetonte larg nga Perëndia. Njëherë, duke ecur përmes një pylli të dendur, u gjend përballë një arushe, që rinte në zgavrën e një peme. Kalimtari u shtang dhe e humbi toruan. U përqëndrua për një çast, e tha: - Perëndia im, ndihmomë!

Pikërisht, atë çast bubullima e shkrepitima mbuluan qiellin dhe një rrufe bie mbi pemën ku gjendej arusha, duke e shndërruar në karbon të zi. Kjo ngjarje u bë shkas që Karamzini ta ndjente të nevojshme për të kërkuar falenderimin ndaj Perëndisë. Që nga ai çast ndërroi mënyrën e të jetuarit, duke u bërë i krishterë shpresëtar. Me të vërtetë, edhe ne, megjithëse nuk kemi raste të tilla në jetën tonë, duhet ta falenderojmë Perëndinë për të na ruajtur në raste nevojë.

KORBA

Në Amerikë ekziston një lule e bukur që quhet korba. Kjo lule hap petalet e saj të bukura dhe indsektet i vërsulen për të thither nektarin. Ndërkohë, ajo i mbyll ngadalë petalet dhe insektet gjejnë vdekjen. Pikërisht këtë gjë bëjnë edhe mëkati. Të gjithë ata që vërsulen për ta shijuar përfundojnë në vdekje shpirtërore. Fatkeqësisht, vdekja është pasojë e mëkatis, sepse e ndan njeriun nga Perëndia dhe e shpie në humbëtirën e ferrit.

SHËNDETI, THESARI MË I ÇMUAR

Njëherë, një fukara i lutej Perëndisë: -Përse o Zoti im, shpërndan kaq pasuri tek të tjerët, ndërsa mua po ma shton varfërinë? Një ditë i shfaqet një engjell i Zotit, duke i treguar pasuritë: -Të kam dhënë shëndetin e syve, të këmbëve, të duarve dhe të trupit. A ka pasuri më të madhe se kjo? Pa mendo njëherë se ka njerëz që vuajnë për këtë...!

U zgjua fukarai, duke e kuptuar gabimin e tij dhe duke parë njerëzit përreth iu drejtua Perëndisë: -Të falenderoj o Zot i gjithëmirisë, që e ke shpërndarë pasurinë tek të gjithë njerëzit.

KRISHTI TROKET

Piktori i famshëm Hollman Hud kishte pikturuar një tabllo të bukur. Tablloja titullohej “Drita e botës” dhe paraqiste një njeri me një fener në dorë që trokiste tek porta e një shtëpie. I afrohet një miku i tij dhe i thotë: - Mjeshtër, keni harruar t’i vini drynin derës. Hollman iu përgjigj: - Një portë e ka gjithnjë drynin nga brenda dhe mund të hapet vetëm nëse dëshiron i zoti i shtëpisë. Piktori ishte frymëzuar nga (Apokalipsi 3, 20) “Ja unë qëndroj tek dera e trokas, nëse dikush dëgjon zërin tim dhe të hapë derën, unë do të hyj tek ai dhe do të ha darkë me të dhe ai me mua”. Krishti paraqitet jashtë zemrës së çdo njeriu dhe troket, nëse ai dëshiron t’ia hapi portën. Krishti na pret. Të mos ngurojmë t’ia hapim portat e zemrës.

DY ARMIQTË

Njëherë, tregonte Ezopi, dy njerëz që e urrenin njeri-tjetrin për vdekje, u gjendën në një anije. Ngaqë nuk donin të shiheshin, njeri qëndronte në fillin të anijes dhe tjetri në fund. Papritur, deti filloi të trazohej e anija rrezikohej të mbytej. Në ato pak çaste që ju kishin mbetur, njeri i afrohet kapitenit dhe i thotë se cila pjesë e anijes do të zhytej në fillim. Kapiteni iu përgjigj: -Më parë anija do të fundosej nga pjesa e fundit. Atëherë, ai i thotë përsëri: -Nuk më vjen keq që do të mbytem, mjafton që të shoh armikun tim të mbytet i pari. Sa herë edhe ne bëhemi skllevër të urrejtjes, duke kërkuar që armiku ynë të fundoset.

DASHURIA E FSHEHTË

Ekziston në Afrikë një pemë që quhet “Dashuria e fshehtë”. Kur e sheh nga larg mrekullohesh nga gjelbërimi i saj, por sapo afrohesh dhe këput një degëz, do të vëresh se mbas gjetheve jeshile fshihen disa lule të vogla, të cilat sa më shumë t’i prekësh lëshojnë aromë të këndshme. E njëjta gjë ndodh me dashurinë e fshehtë. Ajo qëndron brenda zemrës së njeriut, mjafton të këputësh vetëm një degëz dhe t’ia dhurosh vëllait tënd, atëherë ai do të ndjejë aromën e zemrës tënde. Disa degëza të tilla dashurie kërkon edhe nga ne Perëndia, duke u larguar nga urrejtja dhe e keqja.

“MËSHIROI O ZOT”

“Çdo fëmijë që lind është një lajm i gëzuar, se Perëndia nuk na braktisi”. Këto fjalë të thëna nga Abraham Linkoln shprehin një të vërtetë të madhe. Çdo fëmijë që vjen në jetë është një premtim shprese për një jetë të re. Çdo fëmijë është një paraqitje e parajsës, por ekzistojnë njerëz, të cilët me abortet i vrasin këta engjëj. Për këta njerëz vandalë ç’farë do të mund të thoshte dikush: “Mëshiroji o Zot”. Vetëm kaq!

VEND LOTËSH E VAJTIMI

Njëherë, një murg rishtar e pyeti Ava Pimenin: -Çfarë duhet të bëj? Jerondi iu përgjigj: -Abrahami kur shkeli në tokën e premtuar bleu një tokë, si varr të familjes së tij dhe me atë varr trashëgoi vendin. E pyeti sërisht murgu: -Çfarë do të thotë varr? Jerondi i përgjigjet: -Varr do të thotë vend lotësh dhe vajtimi.

KAP ÇASTIN

Në Olimp, në shekullin IV para Krishtit ekzistonte një statujë bronxi kushtuar “kohës”, që kishte kuptimin “Kap çastin e duhur”, vepër e skulptorit Lisip. Në këtë skulpturë paraqitet një njeri me një tufë flokësh në ballë, kurse në pjesën tjetër të kokës qeros. Poeti Posidhipi shkroi për këtë skulpturë këtë mbishkrim, i cili është një dialog ndërmjet një vizitori dhe statujës së “Kohës”.

Në pyetjen e parë të vizitorit “Kush je?”, skulptura e kohës i përgjigjet: -Jam koha që mposht gjithçka. -Përse ecën në majat e gishtërinjve? -Gjithmonë vrapoj dhe nuk ndalem. -Përse keni vetëm një tufë flokësh në ballë? - Që të mundet të më kapi kush të më takojë. -Përse koka juaj është nga prapa qerose? -Që të mos kenë mundësi të më kapin nga pas, sado që të përpiqen. Koha ikën shpejt dhe mjerë ne nëqoftëse nuk do ta kapim çastin e duhur nga tufa e flokëve që ka në ballë.

ANEKDODA TË BOTUARA NË GAZETA DHE REVISTA

- 1-Ati im është Perëndia, Gëzohu, prill 2000, faqe 6.
- 2-Ati im është Perëndia, Ngjallja, tetor 1995, faqe 5.
- 3-Andoni i Madh dhe gjuetari, Ngjallja, nëntor 1997, faqe 5.
- 4-Ava Zinoni dhe kreshmuesi, Ngjallja, nëntor 1997, faqe 5.
- 5-Bagazhet e të krishterit, Ngjallja, korrik 1999, faqe 5.
- 6-Besimi dhe përulësia, Ngjallja, korrik 1995, faqe 5.
- 7-Besimi në përjetësinë, Ngjallja, prill 1999, faqe 5.
- 8-Besimi dhe përulësia, Gëzohu, prill 2000, faqe 7.
- 9-Burimi, Ngjallja, nëntor 1992, faqe 3.
- 10-Dashuria, Gëzohu, prill 2000, faqe 7.
- 11-Dashuria e Eneas, Gëzohu, korrik 2000, faqe 8.
- 12-Diamantet, Gëzohu, mars 2000, faqe 10.
- 13-Dielli dhe lulet, Ngjallja, korrik 1999, faqe 5.
- 14-Diogjeni kërkon, Ngjallja, qershor 1999, faqe 5.
- 15-Do të ribotohet, Ngjallja, korrik 1996, faqe 5.
- 16-Dora e Perëndisë, Ngjallja, qershor 1999, faqe 5.
- 17-Duaje armikun, Ngjallja, gusht 1999, faqe 5.
- 18-Duart më të pastra, Ngjallja, qershor 1999, faqe 5.
- 19-Duke u lëpirë, Ngjallja, shkurt 2000, faqe 5.
- 20-Dy rremat, Ngjallja, tetor 1999, faqe 5.
- 21-Edhe unë jam i krishterë, Ngjallja, gusht 1995, faqe 5.
- 22-Ç'kërkon i rënuri, Gëzohu, korrik 2000, faqe 8.
- 23-Gjithçka për Krishtin, Ngjallja, prill 1999, faqe 5.
- 24-Falenderim ndaj Perëndisë, Gëzohu, korrik 2000, faqe 8.
- 25-Fidani i mbretit, Ngjallja, qershor 2000, faqe 9.
- 26-Filozofi dhe peshkatari, Gëzohu, prill 2000, faqe 6.
- 27-Jerondi i urtë, Ngjallja, prill 1998, faqe 8.
- 28-Hija e gomarit, Gëzohu, korrik 2000, faqe 8.
- 29-Hipokrizia, Ngjallja, shkurt 2000, faqe 5.
- 30-Kap çastin, Ngjallja, mars 1999, faqe 5.
- 31-Këmbëngulja e dashurisë, Ngjallja, gusht 1994, faqe 5.

- 32-Kështu na fal shëndetin, Ngjallja, shkurt 1996, faqe 6.
- 33-Kjo ka vlerë, Ngjallja, dhjetor 1999, faqe 5.
- 34-Kompozitorët e mëdhenj, Ngjallja, qershor 2000, faqe 9.
- 35-Kontakti, Ngjallja, tetor 1999, faqe 5.
- 36-Krahët e dallandyshe, Ngjallja, tetor 1995, faqe 9.
- 37-Krahët e dalandyshe, Gëzohu, prill 2000, faqe 6.
- 38-Krishti të pret, Ngjallja, qershor 1995, faqe 5.
- 39-Krishti troket, Ngjallja, dhjetor 1999, faqe 5.
- 40-Legjendë edukuese, Ngjallja, tetor 1995, faqe 10.
- 41-Oborrtarët dhe shenjtori, ngjallja, shkurt 1996, faqe 6.
- 42-Rrëfim të pastër dhe paqe me të gjithë, Ngjallja, qershor 1996, faqe 6.
- 43-Paqja e Krishtit, Gëzohu, prill 2000, faqe 6.
- 44-Paqja e Krishtit, Ngjallja, shtator 1995, faqe 5.
- 45-Pastroni gjuhën, Ngjallja, prill 1999, faqe 5.
- 46-Pëllumbat dhe bretkosat, Ngjallja, tetor 1999, faqe 5.
- 47-Përpara se të na kërkojë, Gëzohu, mars 2000, faqe 10.
- 48-Përpara se të na kërkojë, Ngjallja, shtator 2000, faqe 5.
- 49-Për kë u kryqëzua Krishti, Ngjallja, prill 1999, faqe 5.
- 50-Përlësia, Gëzohu, prill 2000, faqe 6.
- 51-Qa, ngjallja, shkurt 1996, faqe 6.
- 52-Mbretëresha e virtyteve, Ngjallja, mars 1996, faqe 10.
- 53-Miku i Hygoit, Ngjallja, dhjetor 1999, faqe 5.
- 54-Me dorën bosh, Ngjallja, qershor 2000, faqe 9.
- 55-Mëkati, Ngjallja, shkurt 2000, faqe 5.
- 56-Monedha e mirësisë, Ngjallja, korrik 1999, faqe 5.
- 57-Mos harro armikun, Ngjallja, janar 1998, faqe 5.
- 58-Në majën më të lartë, Ngjallja, mars 1996, faqe 6.
- 59-Nëna, Ngjallja, shkurt 1996, faqe 6.
- 60-Nuk dua të ma tregosh, Ngjallja, mars 1998, faqe 5.
- 61-Nuk ka Perëndi, Ngjallja, tetor 1999, faqe 5.
- 62-Një lugë mjaltë, Ngjallja, shkurt 1996, faqe 6.
- 63-Një mëshiro o Zot, Ngjallja, dhjetor 1999, faqe 5.
- 64-Një libër i ri, Gëzohu, prill 2001, faqe 19.
- 65-Di duhen ruajtur porositë hyjnore, Ngjallja, tetor 1999, faqe 5.

- 66-Skulptori Hyjnor, Ngjallja, qershor 1999, faqe 5.
- 67-Shembëlltyra e Perëndisë, Ngjallja, gusht 1999, faqe 5.
- 68-Shëndeti, thesari më i çmuar, Gëzohu, korrik 2000, faqe 8.
- 69-Tabloja dhe shtëpia, Gëzohu, mars 2000, faqe 10.
- 70-Tani më jep diçka për të varfërit, Ngjallja, tetor 1999, faqe 5.
- 71-Të presësh një minutë, Gëzohu, prill 2000, faqe 6.
- 72-Të pyesni përse nuk ekziston, Ngjallja, tetor 1999, faqe 5.
- 73-Të krishterët në fund duken, Ngjallja, shkurt 2000, faqe 5.
- 74-Ti nuk qan, Ngjallja, shtator 2000, faqe 5.
- 75-Tha i marri...nuk ka Perëndi, Ngjallja, janar 1995, faqe 5.
- 76-Vasil Tushi, Urtësia e shekujve, Ngjallja, prill 2001, faqe 2.
- 77-Vetëm Perëndia, Ngjallja, nëntor 1996, faqe 5.
- 78-Virtyti, Ngjallja, gusht 1999, faqe 5.
- 79-Vdiq për mua, Gëzohu, prill 2000, faqe 7.
- 80-Vdiq për mua, Ngjallja, mars 1996, faqe 6.
- 81-Vlera e lutjes, Ngjallja, tetor 1994, faqe 3.
- 82-Zemërgjerësia e Kostandinit të Madh, Ngjallja, korrik 1996, faqe 5.
- 83-Zerot e përlësisë, Gëzohu, prill 2000, faqe 7.
- 84-Zerot e përlësisë, Ngjallja, shtator 1995, faqe 5.
- 85-Zemra e nënës, Gëzohu, mars 2000, faqe 10.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Gjithçka për Krishtin
Pastroni gjuhën
Besimi në përjetësinë
Rrëfim të pastër
Lutja
Të presësh një minutë
Krahët e dallëndyshes
Ati im është Perëndia
Paqja e Krishtit
Zerot e përlësisë
Dashuria
Besimi dhe përlësia
Vdiq për mua
Oborrtarët dhe shenjtori
Krishti të pret
O jep qiranë ose dil
Qaj
Vlera e lutjes
Një lugë mjaltë
Ava Zinoni dhe kreshmuesi
Tani do zërë vend
T'i flisni Perëndisë

Gjilpëra
Qilimi i çmuar
Më përkasin mua
Tri sitat
Vlera e urtësisë
Në majën më të lartë
Mëkatar jam edhe unë
Andoni i Madh dhe gjuetari
Bëhu më i mirë se armiku
Për kë u kryqëzua Krishti
Në qoftë se....
Edukatorja e trashëgimtarit
Lumturia nuk blihet
Imitova të verbërin
Përçafimi hyjnor
Predikimi më i mirë
Nëna
Paratë
Diogjeni kërkon
Dora e Perëndisë
Burimi
Skulptori Hyjnor
Këmbëngulja e dashurisë
Perëndia i shëh të gjitha
Pastroni udhën
Duart më të bukura
Vdekja dhe të urtët
Shporta e dashurisë
Do të ribotohet
Trimëri dhe mirësjellje

Fidani i mbretit
Ku të shpie mëkati
Perëndia i jep të gjitha
Ekziston shpirti
Vdekja e ëmbël
Hija e mbretit
Pasuria më e madhe
Thjeshtësia
Zemërgjerësia e Konstandinit
Nëna e krishterë
Ngjyra më e bukur
Të krishterët në fund duken
Mëkati
Nëse do të shpëtosh
Shembëlltyra e Perëndisë
Përlësia
Prindërit
Ateisti
Virtyti
Duaje armikun
Monedha e mirësisë
Tetë groshët
“Bagazhet” e të krishterit
Mëkatet e vogla
Braktisja
Unaza e floringjtë
Duke u lëpirë
Mëkati na kërcënon
Dielli dhe lulet

Me dorën bosh
Duart e Perëndisë
Diogjeni dhe vera
Thesaret janë tuajat
Misteri i rrëfimit
Koshi i fajësisë
Dituria e pafund
Kafshoni gjuhën
Shpërblimi më i mirë
Pa u lutur
Nderi dhe paratë
Bashkëpunëtorë Perëndie
Të pyesin përse nuk ekziston
Çfarë preferoi
Miku i Hygoit
Pëllumbat dhe bretkockat
Dy rremat
Ripërtërihet
Për çdo cast
Kënga e ëmbël
Ndëshkimi i mësuesit
Lutjet dhe kreshma
Hipopokrizia
Pasha e provës
Shkaku i mosbesimit
Kjo ka vlerë
Me një vesh
Takohen rrallë
Pas shkrepëtimit fillon shiu

Ata që kërkojnë lavdi
Madhështia e dashurisë
Shembulli i prindërve
Megjithëse na njeh
Më e mira dhe më e keqja
Të mendohemi
Kundërshtari
Në shërbim të mbretërisë
Origjina
Puna e murgut
Thesaret e fshehur
Ilaçi më i mirë
Unë nuk jam asgjë
Rilindje
Shpata e shkurtër
Një hap përpara ose prapa
Tri mënyrat e të jetuarit
Të kujdeseni
Libri më i çmuar
Lavdia
Dy baballarët
E vërteta
Bukuria
Vetëm dy kategori
Do t' i shohi Perëndia
Vetëm shpresa
Sekreti i suksesit
Gjykatësi
Diamantet

Lutja e përditëshme
Dhurata mbretërore
Ti nuk qan
Njeriu dhe kafsha
I gjej brenda meje
Virtyti i përjetësisë
Zemra e nënës
Tabloja dhe shtëpia
Dashuria e Eneas
Përpara se të na kërkojë
Hija e gomarit
Ç'kërkon i rënuri
Kompozitorët e mëdhenj
Dhe me perëndinë dhe me djallin
Përlësia
Filozofi dhe peshkatari
Më mjafton vetëm t'ju shoh
Edhe unë jam i krishterë
Ler atë që t'ju gatujmë diçka
Falenderim ndaj Perëndisë
Korba
Shëndeti, thesari më i çmuar
Krishti troket
Dy armiqtë
Dashuria e fshehtë
"Mëshiroi o Zot"
Vend lotësh e vajtimi
Kap çastin

